



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 80

Tiranë – E enjte, 21 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.4.2015	Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publik..... 3565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 6.5.2015	Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit..... 3566
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 13.5.2015	Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik..... 3566
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 13.5.2015	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 914, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”..... 3567
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 13.5.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 954, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det”, të ndryshuar..... 3567
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 13.5.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, të ndryshuar..... 3569
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 13.5.2015	Për krijimin e Fondit të Inovacionit..... 3570
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015	Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit..... 3571
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 13.5.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e shpenzimeve administrative për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. Arb/14/26, “Albaniabeg Ambient sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë”..... 3592

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 13.5.2015	Për procedurat dhe kushtet për dhënien e përsëritjen e licencës së koncesionit të naftës/jellësve për importimin, eksportimin dhe transportimin e naftës bruto.....	3592
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 13.5.2015	Për shfuqizimin e vendimit nr. 775, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Skavicë”, në lumin Drini i Zi, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, të ndryshuar.....	3597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 13.5.2015	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për ndërtim, për parcelat që do të ndikohen nga ndërtimi, prej shoqërisë TAP AG, i rrugës së kalimit (ndihmëse), “Pronovik-Zgërbonjë-Antena”, qarku Berat.....	3598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 13.5.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për kalimin në përgjegjësinë e saj të ndjekjes dhe zbatimit të projektideve të konkursit “Ëndrra ime”.....	3599
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 415, datë 13.5.2015	Për përdorimin e barnave për konsum minimal nga udhëtarët.....	3601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 417, datë 13.5.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 52, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015”.....	3601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 13.5.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 302, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, lotet 6-11 (objekte dhe toka)”.....	3602
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 420, datë 20.5.2015	Për disa shtesa në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar.....	3603

**VENDIM****Nr. 395, datë 29.4.2015****PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS
NË ADMINISTRATËN SHETETËRORE
DHE INSTITUCIONET E TJERA
PUBLIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, dhe institucionet e tjera publike për profesionistë të rinj (në vijim referuar si “Programi Kombëtar i Praktikave të Punës”).

2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre praktike në njohje me sistemin administrativ publik.

3. Aplikantët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij programi, duhet të jenë të rinj nga moshja 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”.

4. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës zgjat nga 3 muaj deri në 12 muaj, sipas thirrjeve. Përfshirja në këtë program është pa pagesë. Periudha e praktikës së zhvilluar do të njihet si përvojë pune gjatë procedurave të rekrutimit në institucionet e administratës publike.

5. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e cila do të mbështetet nga institucionet e administratës shtetërore dhe institucione të tjera publike që ofrojnë gatishmëri për pranimin e aplikantëve. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të kryejë rolin e sekretariatit teknik të programit për koordinimin ndërinstitutional.

6. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Administrata shtetërore dhe institucionet e tjera publike që mbështetin këtë program duhet të

paraqesin numrin e praktikantëve dhe profilin e tyre. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse në këtë program kanë për detyrë të përcaktojnë 1 person kontakti i cili është përgjegjës për:

a) dorëzimin pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të numrit të praktikantëve për çdo thirrje;

b) ofrimin e kushteve të nevojshme të punës;

c) përcaktimin e një mbikëqyrësi për çdo praktikant;

ç) komunikimin me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Në përfundim të programit, institucioni i lëshon praktikantit vërtetimin për kryerjen e praktikës.

8. Mbikëqyrësi në administratën shtetërore duhet të jetë i konfirmuar me statusin e nëpunësit civil. Në institucionet e tjera publike ai duhet të jetë një punonjës me eksperiencë në punën që kryen.

9. Mbikëqyrësi ka përgjegjësinë:

a) të përcaktojë detyrat dhe angazhimet për praktikantit;

b) të supervizojë, të këshillojë dhe të udhëzojë gjatë realizimit të detyrave të dhëna;

c) të vlerësojë performancën e praktikantit gjatë praktikës;

ç) të përpilojë vërtetimin në të cilin përcaktohen kryerja e praktikës,

njësia pranë së cilës është realizuar praktika dhe përshkrimi i detyrave;

d) të përgatitë vlerësimin përfundimtar për praktikantit;

dh) të gjykojë për arsyet e përfundimit të programit nga ana e praktikantit në rast shkeljeje të marrëveshjes midis institucionit dhe praktikantit.

10. Thirja e parë e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës do të kryhet brenda muajit qershor 2015.

11. Institucionet e administratës shtetërore qendrore, pjesëmarrëse në program, do të punësojnë me kontratë të përkohshme pune 200 praktikantë, të përzgjedhur nga thirrja e parë dhe që kanë kryer praktikën e punës në atë institucion në kuadër të kësaj thirrjeje. Përzgjedhja e praktikantëve kryhet nga secili institucion pjesëmarrës mbi bazën e vlerësimit të performancës, mesatares dhe titullit të studimit që përkon me profilin e pozicionit të punës. Numri i praktikantëve që do të mund të punësohen në thirrjet në vazhdim do të përcaktohet rast pas rasti.



12. Në përfundim të çdo programi, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i raporton Departamentit të Administratës Publike për çdo praktikant për periudhën profesionale si dhe institucionit, pranë të cilit është kryer kjo praktikë. Këto të dhëna regjistrohen nga Departamenti i Administratës Publike në një bazë të posaçme të dhënash.

13. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 11, të këtij vendimi, për vitin 2015, të përballohen nga buxheti i miratuar për këtë vit për çdo institucion të administratës shtetërore qendrore, që do të kryejë kontraktimin.

14. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe të gjitha institucionet e administratës publike, të përfshira në program, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 396, datë 6.5.2015

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH
NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA
BUXHETIT TË VITIT 2015, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE
SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09120, “Arsimi bazë”, shpenzime kapitale, fondi i zhvillimit të rajoneve, të pakësohet shuma në vlerën 92 000 000 (nëntëdhjetë e dy milionë) lekë.

b) Në programin buxhetor 09450, “Arsimi i lartë”, shpenzime kapitale, fondi i zhvillimit të

rajoneve, të pakësohet shuma në vlerën 188 000 000 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milionë) lekë.

c) Në programin buxhetor 09230, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, shpenzime kapitale, fondi i zhvillimit të rajoneve, të shtohet shuma në vlerën 280 000 000 (dyqind e tetëdhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 401, datë 13.5.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS DHE
TË RREGULLAVE PËR PAGIMIN E SAJ
NË NJË PROCEDURË ANKIMIMI NDAJ
PROCEDURAVE TË
KONCESIONIT/PARTNERITETIT
PUBLIK PRIVAT, PRANË KOMISIONIT
TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 63, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ankesa e paraqitur në rrugë elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) nga çdo person që ka ose ka pasur një interes të ligjshëm në një procedurë koncesioni/partneriteti publik privat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, duhet të përmbajë dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse.

2. Përjashtimisht, kur legjislacioni në fuqi parashikon një mjet tjetër komunikimi, ankesa e paraqitur pranë KKP-së shoqërohet me dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse në numrin e llogarisë së KPP-së.

3. Për shqyrtimin e ankesës nga KPP-ja, përcaktohet kjo tarifë pagese, e cila është 10% e vlerës së sigurimit të ofertës në rastet kur është kërkuar një sigurim oferte ose 0.2% e vlerës së



parashikuar të kontratës koncesionare, që ankimohet. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë vlerën e tarifës që kërkohet për shqyrtimin administrativ në dokumentet standarde të koncesionit/ partneritetit publik privat.

4. Parapagimi i tarifës nga ankuesi përbën element të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës, ndërsa moskryerja e tij përbën shkak për mospranimin e ankesës nga KPP-ja.

5. Pagesa e tarifës i kthehet ankimuesit, kur, në fund të procesit të ankimit, ankesa e tij pranohet.

Kur ankesa nuk pranohet, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ankimit derdhen 100 përqind në buxhetin e shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 402, datë 13.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 914, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullave të prokurimit publik, që i bashkëlidhet vendimit nr. 914, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, në nenin 26, të seksionit II, të kreut III, “Dokumentet e tenderit”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 10, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve” zëvendësohet me “Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

b) Pas paragrafit të parë, të pikës 10, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Ky kusht nuk do të zbatohet nëse operatorët ekonomikë janë kontraktorë/nëkontraktorë në një investim/investime dhe nuk i kanë përfunduar

punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, për shkaqe të përligjura, si:

i) vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si KUZ, OSHEE etj;

ii) dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike;

iii) vonesa në shpronësimin e subjekteve, të cilave u përket prona;

iv) ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim;

v) rishpërndarje të fondeve si pasojë e ndonjë emergjence, të justifikuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, sipas dokumentacionit të lëshuar nga ky i fundit.

Në çdo rast, një vërtetim i tillë nuk do të lëshohet për subjektet nëse, sipas grafikut të punimeve pjesë e kontratës, deri në periudhën në fjalë, ato nuk do të mund të kishin kryer më shumë se 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 403, datë 13.5.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 954, DATË 30.9.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN, FUNKSIONIMIN E QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD)DHE BASHKËVEPRIMIN ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, QË KANË INTERESA NË DET”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 3, pika 3, e 4/1, pika 3, të ligjit nr. 8875, datë 4.4.2002, “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 29 e 41, të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008, “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në vendimin nr. 954, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen disa ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. QNOD-ja ka në përbërje strukturore personel nga të gjitha institucionet, që kanë kompetenca dhe kryejnë detyra në bregdet e në hapësirën detare sipas nenit 32, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, siç janë:

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (prani 24-orëshe të administratës detare);

- Ministria e Punëve të Brendshme (prani 24-orëshe të Policisë së Kufirit dhe Migracionit);

- Ministria e Mbrojtjes (prani 24-orëshe të Rojës Bregdetare);

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (prani 24-orëshe të Drejtorisë së Shërbimeve Peshkore dhe Akuakulturës);

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (kapacitete bashkërenduese sipas nevojës);

- Ministria e Financave (kapacitete bashkërenduese sipas nevojës);

- Ministria e Mjedisit (kapacitete bashkërenduese sipas nevojës).”

B. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Përbërja e strukturës së QNOD-së është, si më poshtë vijon:

a) Drejtori administrativ i QNOD-së;

b) Administratorët e sallës operacionale;

c) Koordinatorët e ministrive të linjës;

ç) Personeli i mbështetjes administrative dhe teknike;

d) Oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit të ministrive të linjës.”

C. Në pikën 7 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i) Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Koordinatorët institucionalë me aktivitet të përditshëm në QNOD janë koordinatorët e:

- Ministrisë së Mbrojtjes;

- Ministrisë së Punëve të Brendshme;

- Ministrisë së Financave;

- Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

- Ministrisë së Mjedisit;

- Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.”

ii) Paragrafi i tretë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Oficerët e shërbimit janë oficerët përgjegjës për personelin, që shërbejnë në sallën operacionale të QNOD-së. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave do të kenë oficerë shërbimi 24 orë në sallën operacionale të QNOD-së. Secili oficer shërbimi është përgjegjës për drejtimin e operacioneve, që janë kompetencë e ministrisë që përfaqëson. Për sigurimin e kontrollit civil mbi të gjitha operacionet policore, oficeri i shërbimit, i caktuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, do të marrë përsipër dhe do të ekzekutojë operacionet që lidhen me detyrat e policisë. Përgjegjësitë dhe bashkërendimi i oficerëve të shërbimit përshkruhen në procedurat operacionale të miratuara.”

2. Pika 2, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. QNOD-ja drejton dhe bashkërendon operacionet detare të institucioneve të mëposhtme:

a) Ministrisë së Punëve të Brendshme:

i) Operacionet detare për kontrollin e kufirit dhe të luftës kundër trafikut të paligjshëm;

ii) Operacionet detare të luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar;

iii) Operacionet detare për detyra të tjera policore.

b) Ministrisë së Mbrojtjes:

i) Operacionet e kërkim-shpëtimit dhe dhënies së ndihmës në det;

ii) Operacionet detare për kontrollin e legjislacionit për sigurinë hidrolundimore;

iii) Me kërkesë të strukturave të Policisë së Shtetit dhe atyre doganore siguron mbështetje për misionet e zbatimit të ligjit;

iv) Kur për veprimet e ndërmarra sipas nënndarjes “ii” më sipër, kërkohen atributet e policisë gjyqësore, vetëm personeli i Rojës Bregdetare apo i Forcës Detare, i cili gëzon këtotribute dhe ka trajnimin e përshtatshëm, mund t'i kryejë këto veprime. Trajnimi i nevojshëm përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrive të përfshira dhe të Prokurorisë së Përgjithshme.



c) Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:
i) Operacionet detare për kontrollin e legjislacionit për trafikun detar;

ii) Hetimin e incidenteve detare.

ç) Ministrisë së Financave, operacionet detare për kontrollin e legjislacionit fiskal dhe doganor.

d) Ministrisë së Mjedisit, operacionet për parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja.

dh) Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes:

i) Operacionet në mbështetje të sporteve ujore dhe nëujore;

ii) Operacionet në mbështetje të turizmit detar dhe bregdetar.

e) Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, operacionet detare për kontrollin e zbatimit të legjislacionit për peshkimin.”.

3. Pika 1, e kreut VI, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.”.


4. Shtojca nr. 1 ndryshohet dhe zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Shtojca nr. 1



VENDIM Nr. 405, datë 13.5.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 50, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA E TË PLANIT TË VEPRIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, “Për miratimin e

buxhetit të vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 7, të shkronjës “A”, “Hyrje dhe të dhëna paraprake”, të Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura e të planit të veprimit, miratuar me vendimin nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Në kuadër të Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura, do të



trajtohen edhe kërkesat e paraqitura në institucionet buxhetore për shlyerjen e detyrimeve për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë pas datës 31.12.2013, por që procesi i gjykimit dhe vendimi i shkallës së parë të gjykimit është përpara datës 31 dhjetor 2013.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 406, datë 13.5.2015

**PËR KRIJIMIN E FONDIT TË
INOACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit të Inovacionit, me vlerë të përgjithshme 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 3 (tre) vjet, për periudhën 2015-2017. Fondi i krijuar fillon të zbatohet në vitin 2015 me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për vitin 2015, vlera e fondit të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

b) Për vitin 2016, vlera e fondit të jetë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

c) Për vitin 2017, vlera e fondit të jetë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Fondi i Inovacionit, përveç fondeve nga buxheti i shtetit të parashikuara si më sipër, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

3. Fondi i Inovacionit u jep ndihmë, në formë granti të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga aplikanti/tët, skema mbulon 50% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, brenda kufirit të lartpërmendur. Përfitimi i ndërmarrjeve

nga mbështetja e programeve apo projekteve për mbulimin e 50% të shpenzimeve të tjera të projektit, që nuk mbulohen nga Fondi i Inovacionit, duke përdorur fonde nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga Fondi i Inovacionit për të njëjtin projekt.

4. Në kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:

a) auditim të kapacitetit inovativ dhe teknologjik që synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante vlerësimin për nivelin ekzistues të teknologjisë dhe mundësitë për rinovimin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvillimi;

b) ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin;

c) pjesëmarrje në panairë inovacioni /teknologjie/RDI dhe të ngjashme;

ç) promovim në lidhje me inovacione të ndërmarrjes;

d) kostot e licencave (*software ose hardware*) ose patentave.

5. Përfitojnë nga Fondi i Inovacionit ndërmarrjet, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) Janë biznese, të klasifikuara si mikro, të vogla apo të mesme, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, të ndryshuar.

b) Kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

c) Prodhojnë në Shqipëri produkte dhe/apo ofrojnë shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit.

6. Pagesa e subvencionit bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në fund të përfundimit të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

7. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit të Inovacionit, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë.

8. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit të Inovacionit.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e ministrisë



përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 408, datë 13.5.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së zhvillimit të territorit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, si dhe për përmbajtjen, strukturën e procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të autoriteteve të zhvillimit për ushtrimin e funksionit të kontrollit të

zhvillimit të territorit, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Neni 2
Përkufizime

I. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ligj”, ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

2. “Punime të mirëmbajtjes së zakonshme”, ndërhyrjet për riparimin apo zëvendësimin e rifiniturave ekzistuese të ndërtesave, si dhe ato që janë të nevojshme për të mbajtur në efikasitet impiantet teknologjike ekzistuese.

3. “Punime të mirëmbajtjes së jashtëzakonshme”, punimet dhe ndryshimet e nevojshme për rinovimin ose zëvendësimin e pjesëve, edhe ato strukturore të ndërtesave, si dhe për realizimin e shërbimeve higjieno-sanitare dhe teknologjike, me kusht që këto punime të mos sjellin shtesë të numrit të njërive dhe/ose ndryshim të përdorimit, vëllimit apo sipërfaqes së njërive.

4. “Njësi individuale”, një pjesë e ndërtesës së banimit, e destinuar ose që është në pronësi individuale, e cila, së bashku me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi, përbën një pjesë të veçantë pasurie të paluajtshme.

5. “Punime rikonstruksioni”, punimet që konservojnë, konsolidojnë apo transformojnë objektin ekzistues përmes punimesh sistematike, ku objekti që i nënshtrohet rikonstruksionit mund të pësojë ndryshime, ku përfshihen zëvendësimi, eliminimi, ndryshimi i pjesëve strukturore të tij dhe elementeve të reja.

6. “Rindërtim”, punimet që konsistojnë në prishjen dhe rindërtimin me të njëjtin vëllim dhe formë të objektit të mëparshëm.

7. “Sporteli i shërbimit”, sporteli i shërbimit me një ndalesë, sipas pikës 6, të nenit 3, të kësaj rregulloreje.

8. “Zhvillues”, çdo person fizik ose juridik që investon dhe realizon një zhvillim në një zonë ose njësi ku lejohet zhvillimi.

9. “Zhvillim kompleks”, ai lloj zhvillimi, që përfshin, për shkak të veçorisë së zhvillimit, interesit shtetëror dhe/ose kompleksitetit të tij, një ose disa ndërtime sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje.



10. “Kushtet e zhvillimit”, në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termin “kushte zhvillimore, sipas përcaktimit të ligjit.

II. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

PJESA II ZHVILLIMI I TERRITORIT

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Sporteli i shërbimit me një ndalesë

1. Pranë çdo njësie bazë të qeverisjes vendore ngrihet sporteli i shërbimit me një ndalesë për veprimtaritë ndërtimore, i cili kujdeset për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet palës së interesuar, autoritetit vendor të planifikimit dhe organeve të tjera të administratës publike që kanë detyrimin të japin mendimin e tyre në lidhje me punimet, objekt i kërkesës për leje ndërtimi apo deklaratës për punime paraprake.

2. Sporteli i shërbimit përbën pikën e vetme të kontaktit të palës së interesuar me administratën publike në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi dhe ndërhyrjen përkatëse në territor.

3. Autoriteti vendor i planifikimit është përgjegjës për bashkërendimin e punës me të gjitha institucionet shtetërore dhe operatorët e shërbimeve publike, që mbulojnë fushën përkatëse të veprimtarisë në territorin ku kryhet zhvillimi, për t’u siguruar se projekti, për të cilin kërkohet pajisja me leje, nuk ndërhyr apo dëmton zonat e mbrojtura, monumentet e kulturës, trashëgiminë kulturore apo rrjetet e infrastrukturës. Për këtë qëllim, sporteli i shërbimit merr sipas rastit aktet e pëlqimit, sido që të jenë të emërtuar nga legjislacioni në fuqi, nga autoritetet që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e mjedisit, të trashëgimisë kulturore e historike, të shëndetit dhe të sigurisë publike.

4. Komunikimet me aplikuesit mbahen vetëm nga sporteli i shërbimit.

5. Sporteli i shërbimit kryen, në mënyrë të veçantë, veprimet, si më poshtë:

a) U ofron personave të interesuar të gjitha informacionet e nevojshme për realizimin e

ndërtimit, përpara dorëzimit dhe gjatë shqyrtimit të aplikimit, përfshirë:

i) fragmente nga harta e gjendjes ekzistuese të pasurisë/ve;

ii) hartat e infrastrukturave inxhinierike ekzistuese në zonë, për identifikimin e pikave të lidhjes, përkatësisht për furnizimin me ujë, largimin e ujërave të zeza, rrjetin elektrik, rrjetin e komunikimit elektronik dhe pikat rrethuese të depozitimit të mbetjeve;

iii) hartat me hapësirat e gjelbra publike dhe fondin e drurëve rreth apo në parcelën/parcelat për zhvillim;

iv) informacione rreth kufizimeve apo kushtëzimeve të veçanta sektoriale në zonën objekt studimi, si ato të monumenteve të kulturës, mjedisit etj., sipas rastit;

v) çdo informacion tjetër të nevojshëm për kryerjen e detyrës së projektimit.

b) Merr në dorëzim deklaratat paraprake për punime, kërkesat për leje zhvillimi, kërkesat për leje ndërtimi, si dhe çdo akt pëlqimi, sido që të jetë i emërtuar, në fushën e veprimtarisë ndërtimore;

c) Dorëzon lejet e zhvillimit, lejet e ndërtimit dhe certifikatat e përdorimit.

6. Institucionet shtetërore dhe operatorët e shërbimeve publike kanë detyrimin që brenda 10 ditëve nga kërkesa t’i njoftojnë autoritetit përgjegjës, në rrugë elektronike, aktet e pëlqimit/miratimit lidhur me zhvillimin e propozuar. Në mungesë të përgjigjes brenda afatit 10-ditor, pëlqimi/miratimi konsiderohet i dhënë, sipas parimit të miratimit në heshtje, dhe autoriteti i planifikimit ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për leje, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 44, të ligjit.

7. Për lejet që miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit, funksionet e sportelit të shërbimit si më sipër kryhen nga sekretariati i KKT-së.

Neni 4

Dokumentacioni i administratës publike

Autoriteti i zhvillimit është i detyruar të marrë vetë kryesisht të gjithë dokumentacionin, informacionin apo të dhënat, përfshirë ato kadastrale dhe të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që posedohen nga administrata publike, për nevoja të shqyrtimit dhe



vendimmarrjes përkatëse. Autoriteti i planifikimit nuk mund të kërkojë vërtetime nga personi i interesuar lidhur me vërtetësinë apo autenticitetin e këtyre dokumenteve apo të dhënave.

Neni 5

Rregulloret vendore të kontrollit të zhvillimit

Njësitë bazë të qeverisjes vendore, në ushtrimin e autonomisë së tyre, mund të miratojnë rregullore vendore të kontrollit të zhvillimit për të disiplinuar veprimtarinë ndërtimore në territorin e tyre administrativ. Këto rregullore përmbajnë rregullat, kushtet dhe mënyrën e ndërtimit, në mënyrë të veçantë, respektimin e dispozitave tekniko-estetike, higjieno-sanitare dhe të sigurisë së objekteve, në çdo rast në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

TITULLI II

DOKUMENTET DHE PROCEDURAT E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 6

Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi

Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, ndërhyrjet e mëposhtme kryhen pa pajisje me leje ndërtimi:

a) Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, që përfshijnë:

i) ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si vijon:

- rifreskimi i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese;

- pastrimi i fasadave;

- riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si forma, ngjyra,

dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;

- zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;

- riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve dhe oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;

- riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;

- vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;

- vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;

- lëvizja e shtresave të sipërme të oborreve;

- riparimi i rrethimeve ekzistuese.

ii) ndërhyrje të brendshme:

- riparimi dhe rinovimi i dyshemeve;

- riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;

- riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave të dyfishtë.

iii) ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare:

- veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;

b) Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;

c) Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore.

Neni 7

Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh

Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, punimet e mëposhtme kryhen pa pajisjen me leje ndërtimi, pas njoftimit të deklaratës paraprake të fillimit të punimeve pranë autoritetit kompetent të planifikimit dhe zhvillimit:

i) Punime të jashtme, si:

- ndërhyrjet e mirëmbajtjes së zakonshme kur sjellin ndryshime të karakteristikave, formave dhe ngjyrave ekzistuese;

- punimet mirëmbajtëse për mbulesat;



- vendosja e shtresave për rritjen e efikasitetit të energjetike të ndërtesave ekzistuese.

ii) Punime të brendshme, si:

- përforsimi i strukturave mbajtëse të brendshme;

- hapja dhe mbyllja e derve të brendshme;

- krijimi, eliminimi ose ndryshimi i mureve ndarëse (jombajtëse) të brendshme, i mjedisëve për shërbime higjienike;

- realizimi i impianteve të reja higjieno-sanitare dhe të ngrohjes/ftohjes;

- punimet për ndërtimin e rampave për përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;

- struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe të përkohshme, pa themele dhe që hiqen në çdo rast brenda një afati kohor maksimal 150-ditor;

- vendosja e paneleve diellore, fotovoltaike, në shërbim të ndërtesave, jashtë zonave të trashëgimisë historike, kulturore apo zonave të mbrojtura mjedisore, ku vendosja e tyre është e ndaluar;

- punime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtje e rrjeteve të infrastrukturës publike, që nuk prekin sistemin konstruktiv të tyre, nuk ndryshojnë përdorimin dhe përmasat e infrastrukturës si dhe kushtet e zhvillimit në zonën përreth;

- punime riparimi, mirëmbajtje dhe rehabilitimi të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja;

- vendosja e tendave të diellit dhe pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit dhe rregulloren arkitektonike të qytetit;

- ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e efikasitetit të energjetike dhe akustike në një strukturë ekzistuese, që nuk prekin sistemin konstruktiv të ndërtesës (p.sh. ndërhyrje në themele, mure mbajtëse, tra-kolonë etj.);

- serra të çmontueshme, pa themele të vazhduara, në shërbim të aktiviteteve bujqësore;

- vendosja e reklamave në fasadat e jashtme për qëllime të promovimit të aktivitetit ekonomik privat. Vendosja e tyre rregullohet sipas rregullores specifike të secilit autoritet vendor të planifikimit. Vendosja e reklamave jashtë territoreve urbane, si p.sh., rrugë interurbane, hekurudha, mjedise aeroportuale, pika doganore rregullohen me akte të ministrive përgjegjëse.

Neni 8

Dokumentacioni për punime me deklaratë paraprake

1. Dokumentet që duhet të depozitohet personi i interesuar, në letër dhe CD (format pdf), për njoftimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh janë:

a) Formulari i deklaratës, sipas shtojcës D, të kësaj rregulloreje, në dy (2) kopje, dhe, sipas rastit;

b) Dokumenti që vërteton pronësinë e tij apo të drejta të ligjshme për pasuri private apo publike për strukturën që ka në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) Projekti teknik i realizimit të punimeve, i firmosur nga projektues të licencuar.

2. Dokumentet, sipas pikës 1, të këtij neni, janë dokumentet e vetme që duhet të paraqesë aplikuesi për kryerjen e punimeve.

3. Autoriteti i planifikimit dhe zhvillimit nënshkruan formularin e deklaratës sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 9

Leja e zhvillimit

1. Dokumenti i lejes së zhvillimit përmban, në nivel njësie:

a) përdorimin e tokës;

b) intensitetin e ndërtimit;

c) koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim;

ç) lartësinë maksimale në metra;

d) distancat;

dh) gjelbërimin publik;

e) parkimin.

2. Për rastet kur leja e zhvillimit del si rezultat i një PDV-je, ajo përmban edhe kufijtë e pronës në bazë të planit të detajuar vendor dhe, sipas rastit, volumetrinë e së drejtës së zhvillimit dhe truallin ose ndërtimin ku do të ushtrohet ajo.

3. Autoriteti i planifikimit mund të përcaktojë në lejen e zhvillimit edhe rregulla arkitektonike dhe instrumente të zbatueshme të drejtimit të zhvillimit, ndër ato të parashikuara në nenet 30 deri në 36, të ligjit.

4. Leja e zhvillimit jepet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 26, të kësaj rregulloreje.



Neni 10

**Dokumentacioni për pajisjen me leje
zhvillimi**

Dokumentet që duhet të paraqesë personi i interesuar për të marrë informacion mbi të drejtat e zhvillimit janë:

- a) Kërkesa për leje zhvillimi, e cila përmban:
 - i) të dhëna identifikuese të pasurisë së paluajtshme dhe pronarëve;
 - ii) NUIS-in e subjektit aplikues, në rast se është person juridik.
- b) Taksa e aplikimit.

KREU II**LEJET E NDËRTIMIT**

Neni 11

**Punime për të cilat kërkohet pajisja me
leje ndërtimi**

Punimet, për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39, të ligjit, janë ato që:

- a) rezultojnë në krijimin e ndërtimeve e reja, përfshirë ato të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë rregullore;
- b) rezultojnë në rikonstrukcion, riparim dhe restaurim që çojnë në krijimin e një strukture tërësisht ose pjesërisht të ndryshme nga ajo e mëparshme dhe që kanë si pasojë shtimin e njësive dhe/ose ndryshimin e vëllimit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtimit, pamjes së jashtme të objektit, të përdorimit ose të sistemit konstruktiv;
- c) realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme sipas kësaj rregulloreje, të shoqëruar me ndryshime të sistemit konstruktiv të objektit;
- ç) kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes.

Neni 12

Ndryshimi i aktiviteteve/funksioneve

1. Leja për ndryshimin e aktiviteteve dhe funksioneve të njësive individuale, jepet nga autoriteti i planifikimit, me kusht mosndryshimin e sistemit konstruktiv, në bazë të përputhshmërisë me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës të përcaktuara nga PPV-ja ose PDV-ja.

2. Në mungesë të PPV-së ose PDV-së, ndryshimi i aktiviteteve dhe funksioneve duhet të bëhet në përputhje me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit ekzistues të tokës.

Neni 13

Veçori të lejes së ndërtimit

1. Leja e ndërtimit i lëshohet zhvilluesit ose një personi të autorizuar prej tij, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Leja e ndërtimit është e transferueshme, me ndryshimin e subjektit përfitues të lejes së ndërtimit, dhe kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi.

3. Transferimi i lejes së ndërtimit gjatë afatit të zbatimit të saj duhet t'i komunikohet sportelit të shërbimit pranë autoritetit që ka lëshuar lejen, bashkërisht me aktet zyrtare që vërtetojnë kalimin e titullit mbi lejen e ndërtimit.

4. Zyra përgjegjëse pranë autoritetit kompetent kryen verifikimet lidhur me transferimin e lejes dhe, në rast se nuk vëren parregullsi, kryen pa vonesë regjistrimin e të dhënave të titullarit të ri të lejes në regjistrat përkatës dhe informon palët e interesuara.

5. Për strukturat që prokurohen me fonde publike, lejen e merr organi që realizon prokurimin, përpara se të japë në sipërmarrje ndërtimin e strukturës.

Neni 14

Kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit

1. Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me përcaktimet e dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Dhënia e lejes së ndërtimit kushtëzohet nga ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore në njësinë ku kërkohet ndërtimi. Ndërtimi i infrastrukturës mund të realizohet, sipas marrëveshjes me autoritetin e planifikimit dhe zhvillimit, me kontribut financiar ose në natyrë, sipas formave të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Lejet e ndërtimit jepen vetëm pasi janë marrë lejet dhe autorizimet përkatëse për ndërtimin në fjalë, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.



Neni 15

Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi

1. Dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për leje ndërtimi janë:

a) kërkesa për leje ndërtimi, sipas formularit tip të shtojcës A;

b) dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;

c) fragmenti i hartës së parcelës/ave ku do të kryhet zhvillimi, i rëluar nga topograf i licencuar;

ç) plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;

d) projekti teknik arkitektonik dhe i peizazhit, sipas rastit, në 2D dhe 3D, përfshirë eliminimin e barrierave arkitektonike;

dh) projekti konstruktiv;

e) projekti i instalimeve që përfshijnë ato hidrosanitare, elektrike, ngrohje, ventilim, mbrojtje nga zjarri, eficiencë energjetike, shkallë emergjence;

ë) grafiku paraprak i punimeve dhe afati i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit;

f) preventivi;

g) deklarata e projektuesit të licencuar, sipas shtojcës B, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në fuqi dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;

gj) lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm sektorial, sipas rastit.

h) mandatpagesa/t e tarifës/tarifave të aplikimit, për të gjitha proceset e shërbimit me një ndalesë.

2. Në rastin kur kërkesa për leje paraqitet për shqyrtim pranë sportelit të shërbimit, sipas nenit 3, pika 1, shkronja “b”, aplikuesi i dorëzon dokumentet e mësipërme në letër dhe CD (format pdf).

3. Dokumentet të cilat janë të konsultueshme nga publiku në regjistër janë:

a) formulari i aplikimit për leje;

b) fragmenti i hartës i gjendjes ekzistuese;

c) plani i vendosjes së ndërtimit;

ç) fasadat teknike, sipas rastit;

d) 3D foto.

4. Kërkesa për leje ndërtimi, dokumentacioni shoqërues dhe dokumenti i lejes duhet të përdorin terminologji ose kuptime termash të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe terminologjia, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në dispozitat ligjore në fuqi, duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Neni 16

Përmbajtja e lejes së ndërtimit

Në dokumentin e lejes së ndërtimit, sipas shtojcës C, të kësaj rregulloreje, përcaktohen:

a) autoriteti përgjegjës që lëshon aktin dhe identiteti i zyrtarit që përfaqëson autoritetin;

b) data dhe numri i lejes së ndërtimit, që korrespondon me numrin e praktikës në regjistër;

c) data dhe numri i vendimit të kryetarit për miratimin e lejes;

ç) afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve;

d) të dhënat identifikuese të pronarit të tokës;

dh) adresa dhe kufijtë e pasurisë;

e) të dhënat identifikuese të zhvilluesit;

ë) përshkrimi i ndërtimit të miratuar dhe kushtet e zhvillimit.

Neni 17

Rishikimi i kushteve të lejes së ndërtimit

1. Rastet në të cilat rishikohen kushtet e lejes, sipas nenit 48, të ligjit, pa zmadhuar vëllimin e përgjithshëm të ndërtimit, pa ndryshuar përdorimin dhe kushtet e zhvillimit nga ato të përcaktuara në dokumentet e planifikimit në fuqi dhe nga projekti arkitektonik dhe peizazhistik janë ndryshime:

a) të sistemit konstruktiv të objektit apo të punimeve teknike në zbatim;

b) të numrit dhe formës së njësive brenda objektit;

c) për përmirësimin e eficiencës energjetike;

ç) në instalime për sa kohë që rritet cilësia e punimeve;

d) për të shtuar elemente arkitektonike për përdorim të barabartë dhe të pavarur të hapësirave të projektuara nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuara;

dh) ndryshime në fasadë.

2. Rishikimi bëhet me procedurë të përsheptuar sipas nenit 24, të kësaj rregulloreje.



Neni 18

Shtyrja e afatit të lejes së ndërtimit

1. Shtyrja e afatit të lejes së ndërtimit bëhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, me kërkesë të subjektit zhvillues të përcaktuar në lejen e ndërtimit.

2. Procedura e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit është e përcaktuar në nenin 40, të ligjit.

3. Për lejet e ndërtimit, të cilave u ka mbaruar afati dhe nuk kanë filluar punimet, duhet të bëhet aplikim për leje të re.

Neni 19

Lejet e ndërtimit për të cilat është përgjegjëse KKT-ja

1. Llojet e zhvillimit komplekse për vendimarrjen e të cilave është përgjegjës Këshilli Kombëtar i Territorit, në bazë të nenit 28, të ligjit, janë:

a) centralët prodhues të energjisë, pjesë e sistemit elektro-energetik të vendit, në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi;

b) impiantet e prodhimit dhe të përpunimit të gazit, naftës e bitumeve, naftës-jellësit dhe gazsjellësit, depot e naftës, gazit dhe derivateve të naftës me kapacitet mbi 500 tonë;

c) impiantet e trajtimit dhe strukturat e depozitimit të mbetjeve, të ngurta dhe të lëngshme, të çdo lloji, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura sipas klasifikimeve të legjislacionit të posaçëm në fuqi;

ç) aeroportet, portet e pasagjerëve, portet dhe terminalët, të çdolloj natyre dhe madhësie sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi;

d) korpuset universitare, qendrat universitare dhe të kërkimit shkencor, përfshirë kampuset;

dh) spitalet, qendrat dhe kompleksët spitalore;

e) strukturat e institucioneve ndëshkuese dhe edukuese;

ë) kompleksët dhe fshatra turistike, komplekse parqesh ujore, argëtimi apo zbavitjeje, që përmbajnë ujë në basen mbi 5 000 m³, impiante skish, teleferikë dhe infrastruktura ndihmëse;

f) muzetë dhe teatrot kombëtarë, veprat monumentale me rëndësi kombëtare, objektet në zonat e mbrojtura në përputhje me ligjin sektorial;

g) pikat doganore dhe kufitare;

gj) minierat, kriporet, karrierat, pika nxjerrjeje dhe shfrytëzimi inertesh;

h) strukturat dhe infrastrukturat ushtarake sipas legjislacionit të posaçëm;

i) stacionet dhe objektet e Policisë së Shtetit apo shërbimeve inteligjente;

j) stacionet e shërbimit zjarrëfikës;

k) Banka e Shqipërisë;

l) Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut;

ll) strukturat dhe qendrat e prodhimit e të përpunimit të industrisë metalurgjike, farmaceutike, kimike, armëve, lëndëve plasëse apo teknologjisë së lartë;

m) qendrat apo institucionet në të cilat kryhen veprimtari, përfshirë kërkimore dhe eksperimentale në fusha të industrisë kimike, fizikës bërthamore dhe të tjera, që klasifikohen nga legjislacioni i posaçëm në fuqi si me rrezikshmëri të lartë;

n) pjesët përbërëse të rrjeteve apo sistemeve të infrastrukturave kombëtare (hekurudha, metro, tramvaj, rrugë, autostrada, rrjete kabllore nënujore, nëntokësore dhe ajrore, objekte dhe rrjete të furnizimit me ujë, objektet, rrjetet e komunikimit elektronik me shtrirje apo ndikim kombëtar ose rajonal);

nj) strukturat dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura etj., të cilat janë nën përgjegjësinë e ministrive në fushat e transportit, energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, mbrojtjes së tokës dhe mbrojtjes së sigurisë publike e kombëtare;

o) basente ujore artificiale me kapacitete mbi 10,000 m³;

p) stadiumet me kapacitet 10,000 e më shumë vende për spektatorë;

q) urta dhe tunelet me gjatësi mbi 50 m;

r) vendparkimet publike me kapacitet mbi 5,000 mjete 4+1 ose ekuivalente;

rr) pikat e furnizimit me karburant;

s) investimet strategjike, sipas ligjit përkatës.

2. Elementet përbërëse të zhvillimeve si në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

3. Këshilli Kombëtar i Territorit është autoriteti përgjegjës për miratimin e lejeve të ndërtimit për çështje, zona apo objekte të përcaktuara si të rëndësishme kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore.



Neni 20

Aplikimi dhe procesi i shqyrtimit të kërkesave për leje nga autoriteti vendor

1. Kërkesa për leje ndërtimi paraqitet për shqyrtim:

a) përmes ngarkimit on-line të saj dhe dokumentacionit shoqërues në portalin përkatës, sipas procedurës së përcaktuar në të; ose

b) përmes depozitimit të saj dhe të dokumentacionit shoqërues pranë sportelit të shërbimit; Në këtë rast, detyrimi i ngarkimit on-line të dosjes së aplikimit është përgjegjësi e këtij autoriteti dhe kryhet menjëherë me paraqitjen e kërkesës në sportel dhe në prani të vetë aplikuesit. Në përfundim të ngarkimit në portal, sporteli i dorëzon aplikuesit numrin e identifikimit të kërkesës në regjistër, që mundëson ndjekjen e ecurisë së saj.

2. Autoriteti i planifikimit shpall kërkesën për leje në mjediset e tij publike. Njoftimi qëndron i shpallur deri në vendimmarrjen mbi kërkesën për leje.

3. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës verifikon nëse dokumentacioni është i plotë brenda 5 ditëve nga paraqitja e tyre. Brenda këtij afati shqyrton:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është personi i legjitimuar për të paraqitur kërkesën;

b) plotësimin e plotë dhe të saktë të të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara në formular;

c) paraqitjen e të gjitha dokumenteve shoqëruese të detyrueshme;

ç) pagesën e tarifës së shërbimit/aplikimit.

4. Autoriteti vendos mospranimin e kërkesës nëse nuk përmbush një nga përcaktimet e shkronjave të pikës 3, të këtij neni.

Neni 21

Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor

1. Shqyrtimi teknik fillon nga përfundimi i afatit, sipas pikës 3, të nenit 20, të kësaj rregulloreje.

2. Brenda 35 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për leje, zyra/organi përgjegjës i planifikimit pranë autoritetit vendor kryen shqyrtimin teknik dhe merr kryesisht, përmes sportelit të shërbimit, sikurse parashikuar në pikën 6, të nenit 3, të gjitha opinionet dhe aktet e pëlqimit/ miratimit që mund të jenë të nevojshme, sipas rastit. Në përfundim të shqyrtimit teknik mbi

përputhshmërinë e projektit me legjislacionin në fuqi, zyra/organi përgjegjës i planifikimit dhe zhvillimit përgatit raportin e vlerësimit teknik. Raporti i vlerësimit teknik botohet në regjistër.

3. Në rast se zyra/organi përgjegjës i planifikimit dhe zhvillimit vlerëson se është e nevojshme që të kryhen ndryshime në projektin fillestar, ka të drejtë që, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, të kërkojë kryerjen e këtyre, duke dhënë edhe arsytet përse i vlerëson të nevojshme.

4. Pala e interesuar është e detyruar të kryejë ndryshimet brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e kërkesës. Kërkesa ndërpret afatin sipas pikës 2, të këtij neni, deri në kryerjen e ndryshimit përkatës të dokumentacionit.

5. Afati i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, mund të ndërpritet vetëm një herë nga zyra/organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe vetëm bazuar mbi kërkesën e arsyetuar të dokumenteve që plotësojnë ose saktësojnë dokumentacionin e paraqitur dhe që nuk zotërohen/disponohen nga administrata publike. Në këtë rast, afati rifillon nga data e dorëzimit të dokumentacionit plotësues.

6. Afatet e përcaktuara në këtë nen nuk zbatohen për ndërtimet sipas nenit 24, të kësaj rregulloreje.

Neni 22

Vendimi për lejen e ndërtimit nga autoriteti vendor

1. Vendimi përfundimtar merret nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 20 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit teknik, sipas pikës 2, të nenit 21, më sipër, dhe në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për leje ndërtimi. Kryetari vendos:

a) miratimin e lejes së ndërtimit;

b) refuzimin e lejes së ndërtimit;

c) miratimin me kusht.

2. Vendimi i kryetarit botohet në regjistër nga autoriteti përgjegjës, jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të kërkesës.

3. Dokumenti i lejes i dorëzohet kërkuarit të saj nga sporteli i shërbimit, jo më vonë se 15 ditë nga data e miratimit të kërkesës për ndërtim, me kusht që të jetë kryer pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

4. Në rastin kur kryetari, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk publikon



në regjistër vendimin sipas pikës 1, të këtij neni, dhe raporti i vlerësimit teknik nuk është shprehur negativisht lidhur me kërkesën për leje, atëherë kërkesa konsiderohet automatikisht e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik i regjistrit gjeneron menjëherë vendimin e miratimit. Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik në regjistër. Vendimi i miratimit në heshtje, sipas kërkesës së paraqitur, përbën, së bashku me mandatin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, të vetmet dokumente të nevojshme për fillimin e punimeve.

Neni 23

Përmbajtja e vendimit

1. Vendimi i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi përmban dhe vlerën e taksës që duhet paguar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Vendimi i refuzimit të kërkesës për leje ndërtimi përmban të gjitha shkaqet e refuzimit.

3. Riparaqitja e kërkesës për leje ndërtimi, pas refuzimit të saj, trajtohet si kërkesë e re.

Neni 24

Procedura e përshpejtuar

1. Autoriteti përgjegjës vendos brenda 10 ditëve nga data e dorëzimit të aplikimit për leje ndërtimi me procedurë të përshpejtuar për rastet:

a) e punimeve që kanë vëllim të kufizuar ndërtimi ose impakt të ulët në territor, si:

i) shkallë;

ii) rrethime;

iii) struktura me materiale të lehta e të çmontueshme;

iv) ndryshime fasade etj.

b) kur aplikuesi paguan tarifë aplikimi të barabartë me dhjetëfishin e tarifës së parashikuar për leje ndërtimi;

c) kur punimet janë me vëllim të kufizuar dhe impakt të ulët në territor, si:

i. shtëpi banimi deri në 2 kate, në bazë të rregullave të përcaktuara në dokumentet e planifikimit;

ii. struktura në funksion të aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale.

ç) e ndryshimit të aktivitetit apo funksionit, sipas nenit 12, të kësaj rregulloreje.

2. Autoriteti vendor, në rregulloren vendore të kontrollit të zhvillimit, mund të përcaktojë raste të tjera shtesë që i nënshtrohen procedurës së

përshpejtuar, bazuar në kriteret e shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni.

Neni 25

Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi që miratohen nga KKT-ja

1. Kërkesa për leje ndërtimi nga KKT-ja paraqitet për shqyrtim:

a) përmes ngarkimit on-line të saj dhe dokumentacionit shoqërues në portalin përkatës, sipas procedurës së përcaktuar në të;

b) përmes depozitimit të saj dhe të dokumentacionit shoqërues pranë Sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Territorit.

2. Sekretariati shqyrton kërkesat për leje ndërtimi nga ana formale, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së tyre, sipas ligjit dhe legjislacionit sektorial në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Sekretariati i KKT-së bashkërendon procesin e shqyrtimit teknik me institucionet e tjera publike kompetente, përfshirë autoritetin vendor përkatës, dhe verifikon përputhshmërinë ligjore dhe me dokumentet e planifikimit.

4. Ministria përgjegjëse e linjës dhe institucionet përkatëse të varësisë shqyrtojnë përputhshmërinë me politikën, strategjitë e legjislacionin sektorial dhe kriteret teknike të veçanta për objektin përkatës.

5. Sekretariati i KKT-së bashkërendon punën në një proces të mbyllur me të gjitha autoritetet përgjegjëse për shqyrtimin teknik, përmes regjistrit dhe komunikimit elektronik.

6. Në rast se gjatë periudhës së shqyrtimit teknik, si rezultat i proceseve të bashkërendimit dhe verifikimit, vërehen kundërshti apo mangësi, autoriteti përgjegjës përkatës njofton, kur është rasti, kërkesin për plotësim dokumentacioni apo rishikim të projektit.

7. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për leje ndërtimi dhe bazuar në raportin e vlerësimit teknik në regjistër, KKT-ja vendos për:

a) miratimin e lejes së ndërtimit;

b) refuzimin e lejes së ndërtimit;

c) miratimin me kusht.

8. Vendimi i KKT-së botohet në regjistër nga Sekretariati i KKT-së, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit sipas pikës 7, të këtij neni.

9. Dokumenti i lejes lëshohet nga Sekretariati i KKT-së dhe i dorëzohet kërkesit të saj, jo më vonë se 30 ditë nga data e miratimit të kërkesës për ndërtim dhe vetëm pas pagesës së taksës së



ndikimit në infrastrukturë pranë autoritetit vendor përkatës të planifikimit.

10. Për lejet që miratohen nga KKT-ja, certifikata e përdorimit që vërteton përfundimin e punimeve lëshohet nga autoriteti kombëtar i planifikimit dhe zhvillimit në bashkërendim me autoritetin vendor të planifikimit dhe zhvillimit, në përputhje me ligjin dhe me legjislacionin për disiplinimin e punimeve në ndërtim.

11. Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm pas dorëzimit të deklaratës së përputhshmërisë nga ana e subjektit që vërteton që punimet janë kryer në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë në fuqi.

Neni 26

Rregulla të përbashkëta për kërkesat për leje

1. Kërkesat për leje shqyrtohen përmes botimit në regjistër ose pas depozitimit të saj dhe të dokumentacionit shoqërues pranë sportelit të shërbimit.

2. Kërkesa për leje paraqitet në formën e formularit tip (shtojca A), i plotësuar dhe nënshkruar nga aplikuesi, dhe shoqërohet nga dokumentacioni i kërkuar, sipas kësaj rregulloreje.

3. Formulari tip përmban të paktën këto të dhëna:

- a) Emrin/emërtimin e pronarit të truallit;
- b) Emrin/emërtimin e zhvilluesit/investitorit;
- c) Të dhënat identifikuese të pronës;
- ç) Adresën, përfshirë adresën elektronike, për komunikim;
- d) Të dhëna rreth licencave, autorizimeve dhe lejeve të marra nga subjekti për ushtrimin e veprimtarisë, bazuar në legjislacionin sektorial përkatës;

dh) Listën e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur.

4. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, sipas kësaj rregulloreje, botohen në regjistër, menjëherë me paraqitjen e kërkesës.

KREU III

PËRDORIMI I NDËRTESAVE

Neni 27

Certifikata e përdorimit

1. Aplikuesi paraqet kërkesën për t'u pajisur me certifikatë përdorimi, së bashku me

procesverbalin e kolaudimit, pranë autoritetit të planifikimit:

a) përmes ngarkimit on-line të dokumentacionit të nevojshëm në portalin përkatës, sipas procedurës së përcaktuar në të;

b) përmes depozitimit të dokumentacionit përkatës pranë sportelit të dedikuar për këtë qëllim, pranë autoritetit kompetent të planifikimit; Në këtë rast, detyrimi i ngarkimit on-line të dosjes së aplikimit është përgjegjësi e këtij autoriteti dhe duhet kryer brenda së njëjtës ditë të depozitimit të kërkesës për leje.

2. Në rastet e kryerjes së punimeve me deklaratë paraprake punimesh, deklarata e përputhshmërisë, sipas pikës 2 të nenit 42, të ligjit, është dokumenti i vetëm që nevojitet për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

3. Në rastet e lejeve për grup ndërtimesh sipas pikës 8, të nenit 42, certifikata e përdorimit jepet me përfundimin e punimeve, edhe përpara afatit të përcaktuar sipas fazave të grafikut të punimeve e dorëzimit të objekteve. Grafiku i punimeve dhe fazat e dorëzimit të objekteve mund të ndryshojnë me kërkesën e subjektit zhvillues, në emër të të cilit lëshohet leja e ndërtimit, edhe gjatë kohës së ekzekutimit të lejes sipas ecurisë së punimeve.

4. Aktet e kontrollit të kërkuara nga subjekti zhvillues, në emër të të cilit është dhënë leja, konsiderohen të miratuara nëse brenda 30 ditëve subjektit nuk i është dërguar akti i kontrollit.

5. Në rastin kur kryetari, brenda afatit të përcaktuar, nuk lëshon certifikatën e përdorimit dhe aktet e kontrollit janë pa shkelje dhe është lëshuar akti i kolaudimit pa shkelje, atëherë kërkesa sipas pikës 1 konsiderohet automatikisht e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik i Regjistrit gjeneron menjëherë vendimin e miratimit. Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik në Regjistër. Vendimi i miratimit në heshtje, sipas kërkesës së paraqitur, përbën të vetmin dokument të nevojshëm, së bashku me aktet e kolaudimit, për regjistrimin e pronës në regjistrat e pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi.



TITULLI III ZBATIMI I PDV-SË

Neni 28

Zbatimi i PDV-së

1. Pas miratimit, subjekti hartues i planit të detajuar vendor informon dhe/ose regjistron në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën:

- hartën e parcelave të reja që krijohen nga nënndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese dhe që janë objekt transaksioni vetëm pasi infrastruktura të jetë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në pronësi të autoritetit publik përkatës.

- hartën e infrastrukturave, të cilat kalojnë në pronësi të autoritetit publik përkatës.

2. Subjektet që përfitojnë të drejta zhvillimi bazuar në PDV-në e miratuar, pajisen, mbi bazën e një kërkesë, me leje zhvillimi, në kuptim të nenit 38, të ligjit, sipas kushteve dhe të drejtave të zhvillimit që ka përcaktuar PDV-ja për secilin prej tyre.

Neni 29

Nënndarja e parcelës për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse

1. Të gjitha rastet e nënndarjes së parcelës, mbi bazën e të cilave kryhet një proces zhvillimi, përcaktohen si nënndarje për qëllime zhvillimi.

2. Kushtet për realizimin e nënndarjes së parcelave për qëllime zhvillimi përcaktohen nga çdo autoritet planifikimi në dokumentet e planifikimit dhe në zbatim të kushteve të zhvillimit.

3. Plani i nënndarjes së parcelës për qëllime zhvillimi realizohet si pjesë e planeve të detajuara vendore dhe planeve të detajuara për zonat me rëndësi kombëtare.

4. Parcelat e reja të krijuara nga procesi i nënndarjes regjistrohen në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme vetëm pasi rrjeti rrugor dhe infrastrukturat për secilën parcelë të re të krijuar nga nënndarja të jenë ndërtuar në përputhje me planin e miratuar të nënndarjes dhe regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me marrëveshjen midis zhvilluesit/pronarit dhe autoritetit vendor të planifikimit.

5. Infrastrukturat që regjistrohen në pronësi të pronarëve private të parcelave detyrimisht mirëmbahen prej tyre në përputhje me kushtet

kohore, teknike dhe të cilësisë, të vendosura për këtë qëllim nga njësia e qeverisjes vendore e cila vazhdimisht kontrollon cilësinë e këtyre infrastrukturave.

6. Nuk lejohet nënndarja në tokat me gjeoreziqe apo ku nënndarja mund të krijojë mundësi për gjeoreziqe, përmbytje dhe pengesa në sistemin e kullimit të ujërave.

Neni 30

Kushtet e përgjithshme të nënndarjes së parcelave për qëllime zhvillimi

Kushtet e përgjithshme për lejimin dhe realizimin e nënndarjes së parcelës për qëllime zhvillimi janë:

a) Parcela duhet të ndodhet brenda kufijve të sistemit urban (vija e gjelbër) ose në ato pjesë të sistemit natyror dhe bujqësor që janë përcaktuar për t'u konvertuar në tokë 'truall' nga dokumenti i planifikimit dhe aktet përkatëse ligjore në fuqi;

b) Çdo parcelë që ka sipërfaqe të mjaftueshme për t'u nënndarë disa herë dhe në më shumë se dy parcela, në përputhje me përcaktimet e planit të përgjithshëm vendor;

c) Parcelat, që nuk përmbushin kushtin për zhvillim sipas dokumentit të përgjithshëm të planifikimit, zhvillohen vetëm nëse bashkohen me parcela fqinje për të arritur madhësinë e nevojshme për zhvillim;

ç) Parcelat e reja të krijuara pas procesit të nënndarjes duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me rrugën dhe infrastrukturat publike. Madhësia e daljes së çdo parcele në rrugë kushtëzohet nga vendndodhja tyre në lidhje me rrugën, përcaktohet në përputhje me standardet e Kodit Rrugor dhe në çdo rast është jo më pak se 6 m;

d) Sipërfaqja e parcelave për infrastrukturën, të përfutuara nga procesi i nënndarjes për qëllime zhvillimi, përcaktohet në përputhje me nevojat e infrastrukturës publike që ndërtohet.

Neni 31

Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse

1. Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi kryhet me vullnetin e pronarëve të tyre, si pjesë e planeve të detajuara vendore ose të zonave me rëndësi kombëtare apo përmes lejeve kur:

a) zhvillimi i ri ndryshon përdorimin dhe/ose treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit në



parcelën e krijuar nga bashkimi, nga ato ekzistuese;

b) zhvillimi i ri kërkon krijimin e një parcele të re, me formë dhe përmasa të ndryshme nga parcelat ekzistuese të cilat bashkohen.

2. Çdo autoritet planifikimi duhet të përcaktojë rregullat e bashkimit të parcelave për qëllime të zhvillimit në rregulloret përkatëse vendore të planifikimit dhe të zhvillimit.

3. Në rastet kur bashkimi i parcelave kryhet përmes një lejeje, plani i bashkimit të parcelave, fazat e zbatimit të bashkimit dhe instrumentet e financimit janë pjesë e projektit që shoqëron kërkesën për leje.

4. Gjatë realizimit të bashkimit për qëllime zhvillimi, zbatohen instrumentet financiare të drejtimit të zhvillimit sipas ligjit.

5. Parcelat e reja të krijuara pas procesit të bashkimit duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me rrugën dhe infrastrukturën publike. Madhësia e daljes së çdo parcele në rrugë kushtëzohet nga vendndodhja tyre në lidhje me rrugën, përcaktohet në përputhje me standardet e Kodit Rrugor dhe në çdo rast është jo më pak se 6 m.

TITULLI IV KUSHTET E ZHVILLIMIT

Neni 32

Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie

1. Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie përcaktohen nga autoriteti i planifikimit në PPV dhe/ose PDV dhe janë, si më poshtë:

- Kategoria dhe/ose nënkategoria e lejuar e përdorimit të tokës;
- Lloji i ndërhyrjes në territor (sipas përcaktimeve të rregullores së planifikimit);
- Intensiteti i lejuar i ndërtimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit;
- Numri i kateve;
- Lartësia e strukturave;
- Treguesit e distancave;
- Tipologjia e ndërtimit;
- Vija e kuqe/ndërtimit;
- Koeficienti minimal i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike për njësinë;
- Numri minimal i vendparkimeve publike në përputhje me rregulloren e planifikimit;
- Koeficienti minimal i shfrytëzimit të territorit për rrugë për njësinë;
- Kushte për infrastrukturën;

- Kushte të tjera, sipas rastit, të përcaktuara në rregulloren e planifikimit dhe legjislacionit të posaçëm sektorial.

2. Kushtet e zhvillimit, të detyrueshme për një njësi, përcaktohen në lejen e zhvillimit në përputhje me përcaktimet e kryera sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 33

Treguesit e distancave

1. Treguesit bazë të përcaktuar nga kjo rregullore janë të detyrueshëm për t'u zbatuar nga autoritetet e planifikimit gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

2. Distancat sipas këtij neni duhet të jenë të tilla që të mos cenojnë lirinë e përdorimit të pronës, të krijojnë hapësira publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe të garantojnë siguri individuale dhe shëndetësore.

3. Distancat e përcaktuara në këtë rregullore janë:

- a) distancat midis ndërtimeve;
- b) distancat midis ndërtimit dhe kufirit të parcelës/pronës;
- c) distancat midis ndërtimit dhe kufirit të trupit të rrugës sipas përkufizimit të Kodit Rrugor.

4. Përcaktimi i distancave bëhet nga autoriteti i planifikimit sipas përcaktimeve në këtë rregullore, rregulloren e planit dhe në PDV, në përputhje me këtë nen, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm sektorial në fuqi.

5. Për përcaktimin e distancave vlerësohen:

- a) orientimi dhe diellzimi;
- b) gjendja e ndërtimeve kufitare;
- c) standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë sipas legjislacionit të posaçëm.

6. Orientimi, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të pikës 5, të këtij neni, bëhet drejt jugut në kufijtë deri 40 gradë të tij, sipas rastit duke preferuar drejtimin gjatësor të strukturës përkundrejt orientimit, si dhe garantimi i minimumi 3 orë diell në periudhën 22 shtator - 22 mars, për objektin.

Neni 34

Distancat minimale midis ndërtimeve

1. Distancat minimale midis dy ndërtimeve sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.



2. Në njësitë ku plani parashikon mbushje urbane dhe nuk parashikon hartimin e PDV-së, distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet sipas formulës më poshtë:

$$d = h_{\max} \times k(0.8),$$

nga të cilat, d-distanca minimale; h-lartësia maksimale e ndërtimit më të lartë dhe k(0.8)-koeficienti minimal për ndriçim dhe mbrojtje nga zjarri.

3. Në zonat e reja për zhvillim apo zonat ekzistuese për rihvillim, distanca midis dy ndërtimeve është e barabartë me lartësinë maksimale mbi tokë të ndërtimit më të lartë.

4. Në rastet e zonave historike dhe të mbrojtura monument kulture sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike në zonë.

5. Distancat e ndërtimeve të ndryshme nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë në drejtimin jug, jo më pak se 1,5 herë e lartësisë së përgjithshme të ndërtimit më të lartë të shprehur në metra. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat 2 dhe 3, e këtij neni.

6. Distancat për ndërtimet industriale përcaktohen në përputhje me sigurinë e ndërtimit dhe nga aktiviteti që kryhet në to, sipas legjislacionit të posaçëm, dhe në çdo rast nuk duhet të jenë më të vogla se përcaktimet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni.

7. Distancat për ndërtimet brenda një zone me përdorim hotelier përcaktohen sipas projektit, në përputhje me këtë rregullore, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm dhe atë mjedisor.

8. Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve. Nënkalimet tunel të ndërtesave të gjata janë minimalisht 5 metra të gjera dhe 6 metra të larta, për të lejuar kalimin e lirshëm të ambulancës ose zjarrfikëses.

9. Në rast se faqet që përballin njëra-tjetrën janë kallkan, pra pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, dy ndërtimet mund të vendosen bashkëngjitur në këto faqe mbi bazën e projektit për ndërtesa të bashkëngjitura dhe marrëveshjes përkatëse mes palëve të interesuara. Në mungesë të

marrëveshjes, respektohen distancat sipas pikave në vijim të këtij neni.

Neni 35

Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës

1. Në njësitë ku plani parashikon mbushje urbane dhe nuk parashikon hartimin e PDV-së, distanca minimale e një ndërtimi nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga plani më i afërt i faqes së ndërtimit me kufirin e pronës dhe matet sipas formulës së mëposhtme:

$$d = h_{\max} \times k(0.8)/2$$

nga të cilat, d-distanca minimale; h-lartësia maksimale e ndërtimit më të lartë dhe 0.8-koeficienti minimal për ndriçim dhe mbrojtje nga zjarri.

2. Në zonat e reja për zhvillim apo zonat ekzistuese për rihvillim, distanca minimale e një ndërtimi nga kufiri i pronës është e barabartë me $\frac{1}{2}$ e lartësisë maksimale mbi tokë të ndërtimit më të lartë.

3. Distancat e ndërtimeve nga kufiri i pronës që nuk zbatojnë pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përcaktohen nga dokumenti i planifikimit. Për zona me dendësi dhe/ose intensitet të lartë ndërtimi, parashikohet që ndërtimet të vendosen deri në kufijtë e pronës.

Neni 36

Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës

1. Distanca minimale e një ndërtimi nga trupi i rrugës matet nga plani më i afërt i faqes së ndërtimit me kufirin e rrugës.

2. Distancat minimale të lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës janë ato të përcaktuara në Kodin Rrugor.

3. Për ndërtimet përgjatë hekurudhave zbatohen distancat sipas Kodit Hekurudhor.

Neni 37

Lartësia e ndërtimeve

1. Për llogaritjen apo vlerësimin sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, lartësia e ndërtimeve shprehet gjithmonë njëkohësisht në numër katesh dhe metra.

Lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit:



a) Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit;

b) Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të objektit në terren të sheshtë, deri në kulmin e mbulesës nga jashtë, për mbulesa të pjerrëta;

c) Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe në përputhje me shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.

ç) Sipas përcaktimeve në legjislacionin sektorial për objekte të veçanta.

2. Lartësia e ndërtimit mbi tokë, e shprehur në numër katesh, është e barabartë me shumën e kateve mbi tokë, përfshirë katin ose gjysmë kati nën çati, në përputhje me këtë nen.

3. Për llogaritjen e lartësisë së ndërtimit në metra, për sa kohë që nuk përcaktohet ndryshe nga rregulloret e ndërtimit në fuqi, përdoret sipas rastit:

a) Lartësia dysHEME-dysHEME është 3.00 m.

b) Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe "Bodrum", është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dysHEMENE e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të strukturës;

c) Kati përdhe, në rastet kur shfrytëzohet për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysHEME – dysHEME është 5.00 m.

ç) Kati nën çati është hapësira e shfrytëzueshme për banim ose aktivitet njerëzor, i cili përbën vëllimin e ndërtimit fundor në skajin e sipërm të një ndërtimi dhe mbulohet nga mbulesa e pjerrët e ndërtimit.

d) Në ndërtimet me çati, hapësira nën çati vlerësohet si një kat kur, pjerrësia e saj lejon shfrytëzimin e të paktën 50% të sipërfaqes së përgjithshme të banimit të katit që mbulohet. Kur shfrytëzimi i hapësirës nën çati është të paktën 30% dhe më pak se 50%, kjo hapësirë vlerësohet si gjysmë kati.

4. Për përdorime, funksione dhe aktivitete të tjera, lartësia e katit përcaktohet nga legjislacioni i posaçëm në fuqi dhe nga rregullorja e ndërtimit.

5. Lartësia maksimale e lejuar në zona historike

dhe monument kulture përcaktohet sipas legjislacionit të posaçëm.

Neni 38

Intensiteti i ndërtimit

1. Intensiteti (I) përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore.

2. Intensiteti (I) ekzistues në nivel njësie strukturore është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e sipërfaqeve të parcelave të ndërtueshme në të. Në llogaritjen e (I) për njësinë nuk përfshihen rrugët dhe hapësirat publike, përveç sa përcaktohet në legjislacionin sektorial në fuqi.

3. Intensiteti (I) për çdo njësi pa PDV përcaktohet nga dokumenti i planifikimit dhe zbatohet në çdo parcelë të ndërtueshme brenda njësisë përkatëse, përjashtuar rrugët dhe hapësirën publike.

4. Intensiteti (I) për një zonë përcaktohet në përputhje me këtë rregullore, ligjin dhe legjislacionin e posaçëm në fuqi.

5. Intensiteti (I) si rregull matet në m^2/m^2 , por për ndërtime në funksion të aktiviteteve bujqësore dhe industriale-ekonomike, (I) mund të matet edhe në m^3/m^2 , sipas akteve ligjore të posaçme në fuqi.

Neni 39

Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim

1. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (Ksht) për ndërtim është raporti i sipërfaqes së gjurmës së ndërtimit me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës së ndërtueshme.

2. Ksht-ja për ndërtim matet në përqindje (%).

3. Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërtueshme.

4. Në rastin e infrastrukturave për shërbime publike, Ksht-ja për ndërtim përcaktohet e pavarur nga ndërtimet e tjera dhe sipas nevojave të funksionit dhe legjislacionit të posaçëm.

Neni 40

Koeficientët e shfrytëzimit të tokës për rrugë dhe hapësira publike

1. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për rrugë ose Kshr-ja është raporti midis sipërfaqes së



gjurmës që do të zënë rrugët në një njësi ose zonë dhe sipërfaqes bruto të njësisë/zonës.

2. Kshr-ja paraqitet në % dhe përcaktohet në dokumentin e planifikimit për njësi/zonë, në përputhje me:

- a) numrin e parashikuar të njërive të banimit dhe ndërtimeve të tjera;
- b) distancat e lejuara sipas kësaj rregulloreje;
- c) nevojën për diellzim dhe eliminim zhurmash;
- ç) hapësirën e nevojshme për kalimin e infrastrukturave nëntokësore dhe ajrore;
- d) nevojën për krijimin e lidhjes së çdo objekti të vetëm me rrugën;
- dh) plotësimin e kushteve për nënndarje dhe bashkim parcelash sipas kësaj rregulloreje;
- e) nevojat e trafikut të brendshëm dhe transit;
- ë) nevojën për lidhje të njësisë/zonës me pjesët e tjera të qytetit;
- f) nevojën për për transport urban, lëvizje të këmbësorëve dhe me biçikleta.

3. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike (Kshp) është raporti i sipërfaqes së hapësirave publike, për njësi/zonë me sipërfaqen bruto të njësisë/zonës.

4. Kshp-ja paraqitet në % dhe përcaktohet për njësi/zonë në dokumentin e planifikimit.

5. Si rregull, shuma e përqindjes që zënë parcelat e ndërtueshme në një zonë me Kshr dhe Kshp, është e barabartë me 1 (një).

TITULLI V INSTRUMENTE PËR DREJTIMIN E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Neni 41

Intensiteti i ndërtimit me kushte

1. Programi i intensitetit të ndërtimit me kushte hartohet nga autoriteti vendor i planifikimit në funksion të qëllimit sipas pikës 1, të nenit 30, të ligjit.

2. Autoriteti vendor i planifikimit përgatit hartën e zonave të banimit që mund të jenë subjekt i programit të intensitetit të ndërtimit me kushte, si pjesë të planit të përgjithshëm vendor gjatë hartimit, ose rishikimit të tij. Përcaktimi i intensitetit me kushte për njësitë/ zonat shoqërohet me studimin e kapacitetit mbajtës, si dhe me një plan të detajuar të zbatimit dhe të transparencës publike të programit.

3. Për zonat sipas pikës 2, autoriteti vendor i planifikimit përcakton intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit pa kushte dhe vlerën e intensitetit të ndërtimit shtesë që mund të lejohet me kushte. Vlera maksimale e intensitetit të ndërtimit shtesë që mund të lejohet me kushte nuk mund të tejkalojë asnjëherë intensitetin maksimal të ndërtimit të lejuar pa kushte.

4. Kushtet e tjera të zhvillimit mbeten të pandryshuara ose ndryshohen në përpjesëtim të drejtë me ndryshimin e intensitetit të ndërtimit, pa cenuar standardet e planifikimit, kur autoriteti i planifikimit zbaton programin e intensitetit të ndërtimit me kushte.

5. Zhvilluesit e interesuar për të përfituar nga programi i intensitetit të ndërtimit me kushte mund të konkurrojnë për të marrë pjesë në këtë program.

6. Autoriteti vendor i planifikimit jep të drejtën për zbatimin e intensitetit shtesë të ndërtimit sipas pikës 3 të këtij neni, kundrejt vlerës përkatëse sipas përcaktimit të pikave 7 dhe 8 të këtij neni, përmes marrëveshjeve me palët e interesuara, organizimit të konkurseve ose ankandeve publike.

7. Vlera e së drejtës për zbatimin e intensitetit të ndërtimit me kushte përfitohet nga intensiteti shtesë i ndërtimit, mbi bazën e vlerës së tregut në zonën ku do të ndërtohet sipërfaqja e re e ndërtimit, dhënë nga intensiteti shtesë i ndërtimit.

8. Vlera, sipas përcaktimit të pikës 7 të këtij neni, mund të jetë vlerë monetare, tokë, investime në infrastruktura dhe shërbime publike, si dhe sipërfaqe të ndërtuara për strehim social ose qëllime të tjera publike.

9. Procedurat e zbatimit të programit të intensitetit të ndërtimit me kushte, sipas përcaktimit të këtij neni, botohen në regjistër dhe nëpërmjet një ose disa mjeteve të informimit publik.

Neni 42

Transferimi i së drejtës për zhvillim

1. Programi i transferimit të së drejtës për zhvillim kryhet në funksion të qëllimit sipas pikës 1 të nenit 31 të ligjit në zonat përkatëse kur procesi i planifikimit të territorit ndalon ose kufizon zhvillimin në to.

2. Transferimi i të drejtës për zhvillim kryhet midis pronarëve të tokave që ndodhen në njësitë dhe/ose zonat që janë objekt i transferimit, ose midis personave fizikë apo juridikë të autorizuar



prej tyre dhe autoritetit vendor të planifikimit vetëm në kuadër të një programi të ndërmarrë nga autoriteti vendor i planifikimit për këtë qëllim dhe me vullnetin e pronarëve.

3. Programi për transferimin e të drejtës për zhvillim, sipas pikës 2 të këtij neni, hartohet dhe zbatohet në përputhje me këtë rregullore dhe me planin e përgjithshëm vendor.

Neni 43

Programi i transferimit të së drejtës për zhvillim

1. Autoriteti vendor i planifikimit vendos të lejojë zbatimin e një programi për transferimin e të drejtës për zhvillim mbi bazën e një studimi për njësitë dhe/ose zonat midis të cilave kryhet transferimi i këtyre të drejtave.

2. Studimi, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, hartohet si pjesë e planit të përgjithshëm vendor, gjatë hartimit ose në vijim, duke rishikuar PPV. Njësitë dhe/ose zonat janë objekt i programit për transferimin e të drejtës për zhvillim pas miratimit të PPV.

3. Programi për transferimin e të drejtës për zhvillim përmban:

a) qëllimin e programit në përputhje me këtë vendim;

b) hartën e njësive/zonave prej nga transferohet (dhënëse) dhe të njësive/zonave ku transferohet (marrëse) kjo e drejtë, përfshirë të dhënat e Regjistrit të Pasurive të Paluajtshme për çdo pronë;

c) kushtet dhe procedurat e procesit të transferimit, të dhënat identifikuese të palëve të përfshira në proces, detyrimet dhe përfitimet përkatëse për palët, si dhe formulën për llogaritjen e vlerës së kompensimit të së drejtës për zhvillim që transferohet, përfshirë taksat dhe çdo kosto tjetër, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi;

ç) përshkrimin e procesit të transparencës publike, monitorimit të ecurisë së programit, dhe botimin në Regjister, në përputhje me ligjin.

Neni 44

Kushtet minimale të detyrueshme për transferimin e së drejtës për zhvillim

1. Transferimi i së drejtës për zhvillim sipas këtij vendimi kryhet midis dy ose më shumë njësive të një zone dhe midis njësive të zonave të

ndryshme dhe, në asnjë rast, brenda së njëjtës njësi.

2. Transferimi i së drejtës për zhvillim zbatohet vetëm për intensitetin e ndërtimit dhe vetëm për përdorimin “banim”.

3. Njësitë midis të cilave lejohet transferimi i së drejtës për zhvillim janë:

a) zona dhënëse të së drejtës për zhvillim, të cilat i përkasin kategorisë së përdorimit të tokës bujqësi, natyrore dhe monumente e trashëgimi kulturore dhe ku plani i përgjithshëm vendor nuk lejon ose kufizon maksimalisht zhvillimin;

b) zona marrëse të së drejtës për zhvillim, të cilat i përkasin kategorisë së përdorimit të tokës banim dhe mund të jenë disa ose të gjitha zonat e banimit sipas planit të përgjithshëm vendor.

4. Në zonat marrëse, veç intensitetit maksimal të lejuar të ndërtimit, plani i përgjithshëm vendor përcakton, pas studimit të kapacitetit mbajtës dhe ndikimit social-ekonomik e mjedisor, intensitetin shtesë të ndërtimit që këto zona mund të përfitojnë si rezultat i zbatimit të programit të transferimit të së drejtës për zhvillim.

5. Intensiteti shtesë sipas pikës 4, të këtij neni, nuk mund të jetë asnjëherë më i madh sesa intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit në zonë, në mungesë të programit të transferimit të së drejtës për zhvillim.

6. Vlera e përgjithshme e sipërfaqes shtesë të ndërtimit në zonat marrëse, që krijohet nga zbatimi i programit të transferimit të së drejtës për zhvillim, nuk mund të jetë asnjëherë më e madhe sesa vlera totale e sipërfaqes së ndërtimit që i përket intensitetit të përcaktuar nga plani i përgjithshëm vendor për zonat dhënëse.

7. Vlera e kompensimit të intensitetit të ndërtimit që transferohet përcaktohet përmes formulës që përgatit për këtë qëllim autoriteti vendor i planifikimit dhe rivlerësohet për çdo zonë dhënëse dhe marrëse. Kjo formulë bazohet në vlerën e tokës sipas çmimit të tregut në zonat dhënëse nëse atyre do t'u lejohej të përdornin intensitetin e ndërtimit të përcaktuar nga plani për qëllime të programit të transferimit të së drejtës së zhvillimit.

8. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës dhe nënkategoritë përkatëse të parashikuara nga plani i përgjithshëm vendor për zonat marrëse dhe dhënëse nuk ndryshojnë me zbatimin e programit të transferimit të së drejtës për zhvillim.



9. Gjatë zbatimit të programit të transferimit të së drejtës për zhvillim, kushtet e tjera të zhvillimit në zonat marrëse mbeten të pandryshuara ose përmirësohen në përpjesëtim të drejtë me zhvillimin shtesë, në përputhje me standardet e planifikimit.

Neni 45

Dispozita kalimtare

Deri në miratimin e dokumenteve vendore të planifikimit apo rishikimin e atyre ekzistuese për

Shtojca A

territorin administrativ, kjo rregullore do të zbatohet vetëm për kategoritë e objekteve të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe sipas procedurave të identifikuar në këtë të fundit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Formulari i Kërkesës për Leje Zhvillimi / Ndërtimi

Njësia e qeverisjes vendore/bashkia nr. <i>Adresa zyrtare e njësisë së qeverisjes vendore / bashkisë</i>	Autoriteti përgjegjës i planifikimit nr. <i>Adresa zyrtare e institucionit përgjegjës</i>	Nr. ___prot/datë Vula
---	--	--------------------------

Depozitimi i parë Depozitimi i dytë Depozitimi i tretë Depozitime të tjera

Formulari i kërkesës për leje zhvillimi/ ndërtimi

Kërkesë për leje zhvillimi

Kërkesë për ndërtim të ri
Kërkesë për ndërtim të përkohshëm
Kërkesë për kryerje punimesh rikonstruksioni
Kërkesë për kryerje punimesh riparimi
Kërkesë për kryerje punimesh restaurimi
Kërkesë për kryerje punimesh për mirëmbajtje të jashtëzakonshme
Kërkesë për kryerje punimesh për prishje
Të dhëna shtesë për prerje drurësh
Kërkesë për kryerje punimesh me deklarim paraprak

SEKSIONI 1 – TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. INFORMACION MBI ZHVILLUESIN

Zhvilluesi	Emri i subjektit	NIPT (nëse ka)	
	Adresa : Rr" _____ " Nr. banimit: kodi postal:		
	Tel. #	Cel.#	email.
	Projekti dokumenti i identifikimit i zhvilluesit		
Përfaqësuesi me prokurë i zhvilluesit:			
Emër, mbiemër			
Adresa : Rr" _____ " Nr. banimit:		Kodi postal:	
Tel. #		Cel.# email.	
Dokumenti i identifikimit i përfaqësuesit		Nr.	

2. INFORMACION MBI PROJEKTIN

Projektin	Emri i projektit
	Përshkrimi i saktë i projektit
	Përshkrim nëse projektin kërkon pajisje me leje të tjera referuar legjislacionit sektorial
	Projektin është trajtuar/ kërkesë e mëparshme/ leje qe ka përfunduar afati/ refuzuar/ nr. ___prot.



3. INFORMACION MBI PARCELËN KU DO TË NDËRTOHET

Të dhëna mbi parcelën	Nr. Z.K.	Nr. pasurisë: /lloji i pasurisë	Volumi:	Faqja:
	Adresa e pasurisë			
	Nr. Z.K.	Nr. pasurisë: /lloji i pasurisë	Volumi:	Faqja:
	Adresa e pasurisë			
	Data e lëshimit të dokumenteve të pronësisë:			
	Sip. në m ² e parcelës/ve			
	A ka ndërtesa ekzistuese në këtë pasuri PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> Nëse PO, jepni funksionin për secilën Nëse parcela është përfshirë brenda një dokumenti planifikimi.			

4. INFORMACION MBI PROJEKTUES (IN/IT)

Projektues (in/it)	Emri, mbiemri, nr. i licencës së projektimit/NIPT		
	Adresa:		
	Tel. #	Cel.#	email.

5. TË DHËNA MBI REALIZUESHMËRINË E PUNIMEVE

Kohëzgjatja e realizimit të punimeve _____ muaj TOTAL (paraqit fazat e zbatimit në grafikun e punimeve)

Financimi i punimeve

Lloji i financimit të punimeve të propozuara - PUBLIK PRIVAT PARTNERITET PUBLIK-PRIVAT

Kosto TOTALE e financimit të punimeve në LEK _____ (lek)

Burimi i financimit _____

6. Dokumentacioni që përmban aplikimi për leje:
1.Kushtet e zhvillimit (Ksht, intensiteti i ndërtimit, treguesit e distancave etj.)
2.Plani i vendosjes së parcelës nga genplani kadastral (ZRPP)
3.Plani i vendndodhjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese (nga topograf i licencuar)
4. Projekti teknik arkitektonik dhe i peizazhit, përfshirë eliminimin e barrierave arkitektonike;
5.Projekti konstruktiv
6. Projekti i instalimeve që përfshijnë ato hidro-sanitare
7. Projekti i instalimeve elektrike, ngrohje, ventilim
8. Projekti i mbrojtjes nga zjarri, efikasiteti energjetike, shkallë emergjence
Grafiku i punimeve dhe i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit
9. Preventivi
10.Deklaratat e përgjegjësisë së projektuesve të licencuar, sipas shtojcës B
11.Lejet e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, nëse parashikohen të tilla.
12.Mandat pagesa e tarifës së aplikimit, e cila mbulon të gjitha proceset e shërbimit me një ndalesë.
13.Kopje e mandat pagesës që vërteton shlyerjen e detyrimeve ndaj profesionistëve që kanë hartuar projektet më lart të listuara.
14.Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis
15.Lejet apo dokumentet të cilat e përjashtojnë nga detyrime te ndryshme
<i>Deklaratë përgjegjësie nga subjekti ndërtues për respektimin e kushteve teknike dhe të sigurimit të punonjësve dhe jetës së njerëzve, gjatë kohës që kryhen punime.</i>
•Në mungesë të depozitimit të plotë të dokumenteve të mësipërme, shqyrtimi i kërkesës për kryerje punimesh nuk mund të bëhet.



7. LIDHJA ME INFRASTRUKTURËN

7.1 Lidhja me rrjetin rrugor

a) Lidhja me rrugën/ hyrja

<i>Lidhja nga rruga ekzistuese</i>
<i>Rruga kalon në parcelën e zhvilluesit</i>
<i>Rruga kalon në një parcelë të buaj (pronë publike)</i>
<i>Rruga kalon në një parcelë të buaj (pronë private)</i>

b) Lidhja me rrjetin e kanalizimeve

<i>Rrjeti i kanalizimeve ekziston</i>
<i>Rrjeti i kanalizimeve nuk ekziston por bëhet kërkesë tek drejtoria përgjegjëse për ndërtimin e këtij rrjeti (Të paraqitet kërkesa dhe miratimi)</i>
<i>Përdoret gropë septike</i>
<i>Metodë tjetër (dokumentimi i saj)</i>

c) Lidhja me rrjetin e ujësjellësit

<i>Rrjeti i ujësjellësit ekziston</i>
<i>Vetë furnizim nëpërmjet burimeve nëntokësore</i>
<i>Nuk ka nevojë për rrjet ujësjellësi</i>

d) Lidhja me rrjetin elektrik

<i>Rrjeti elektrik ekziston</i>
<i>Rrjeti elektrik nuk ekziston por bëhet kërkesë tek drejtoria përgjegjëse për ndërtimin e këtij rrjeti (Të paraqitet kërkesa dhe miratimi)</i>
<i>Vetë furnizim (gjeneratorë ose mulli ere)</i>
<i>Nuk ka nevojë për rrjet elektrik</i>

e) Lidhja me rrjetin telefonik

<i>Rrjeti telefonik ekziston</i>
<i>Rrjeti telefonik nuk ekziston por bëhet kërkesë tek drejtoria përgjegjëse për ndërtimin e këtij rrjeti (Të paraqitet kërkesa dhe miratimi)</i>
<i>Nuk ka nevojë për rrjet telefonik</i>

7.2 Depozitimi dhe mbledhja e mbetjeve gjatë kryerjes së punimeve

Trego në planin e lidhjes së strukturës me infrastrukturën, pikën më të afërt të depozitimit dhe llojin.

Nëse pika më e afërt e venddepazitimit të mbetjeve nuk përmbush kushtet teknike për shërbimin dhe mbrojtjen e mjedisit, bazuar në rritjen e ngarkesës pas realizimit të zhvillimit, detyrimisht në projekt duhet të përcaktohet pika e re e grumbullimit dhe lloji.

7.3 Servitutet publike

Trego në planin e lidhjes së strukturës me infrastrukturën vendndodhjen e servituteve dhe llojin.

NËNSHKRIMI

Zhvilluesi ose përfaqësuesi ligjor

Investitori ose përfaqësuesi ligjor

Firmosur në (institucioni)

_____/_____/_____
Data

Firma



Shtojca B

DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE**ARKITEKTI**


“Unë, i/e nënshkruari/a _____, me profesion arkitekt, me licencë profesionale nr. _____, deklaroj me vullnetin tim të lirë e të pakushtëzuar, dhe nën përgjegjësinë time të plotë, se kam hartuar projektin arkitektonik/ konstruktiv për objektin “_____”, në përputhje me të gjitha dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të zbatueshme si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare.

Emër mbiemër:

Firma:

Datë:

Shtojca C



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____/KKT

LEJE NDËRTIMI**I JEPET:****ZHVILLUESIT _____****I REGJISTRUAR SI SUBJEKT ME TË DHËNAT E MËPOSHTME:****LEJA E NDËRTIMIT PËR PUNIMET: _____****ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE _____****AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË DERI NË DATËN _____**

Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. Të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e strukturës, si dhe treguesit e zhvillimit.
2. Të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratuar dhe grafikut të punimeve.
3. Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër ambienti përreth.
4. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit të miratuar të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime në rrjetin publik.
5. Të respektohen normat dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë.
6. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit dhe inspektorati përkatës në fushën e ndërtimit.
7. Në shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në prishje të saj.
8. Afati i fillimit të punimeve është 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj leje.



9. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë _____ mujore nga data e lëshimit të saj, referuar grafikut të punimeve bashkëngitur.

Data e miratimit të lejes kryetari i bashkisë/KKT

Shtojca D

<input checked="" type="checkbox"/> Shëno të saktën		DEKLARATA PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH	
1	Projekti (sipas nenit 8 të Rregullores së Zhvillimit)	Dosja për autoritetin mbikëqyrës Hyrja dhe vula e autoritetit	
2	Parcela (Ku ndodhet objekti)	Rruga, nr. shtëpisë ,komuna, lagjja Certifikata e pronësisë ose e drejta ligjore për strukturën në përdorim Planvendosja e objektit Projekti teknik i realizimit të punimeve i firmosur nga një projektues i licencuar Numri dosjes për autoritetin përgjegjës /leja ndërtimit/shkresa sipas § xxx	
3	Objekti (sipas llojit dhe përdorimit)		
	Llojet e punimeve		
4	Fillimi i punimeve	Projekti fillon me: Mbikëqyrja e realizimit të projektit do të kryhet nga eksperti i autorizuar _____	Dita _____
5	Zhvilluesi	Emër mbiemër / firma (përfaqësuesi ligjor ose zëdhënësi) Rruga, numri shtëpisë, kodi postal, vendi Me këtë vërtetim, unë tregoj fillimin e punimeve sipas datës të shënuar më sipër. Punimet do të fillojnë _____ dite pasi dorëzimit të kësaj deklaratë. Unë jam i vetëdijshëm se një devijim nga plani e ndërtimit të miratuara dhe nga kërkesat e ligjeve në fuqi për interesin publik mund të hapin procedura për kundërvajtje kundër meje.	Telefon _____ Fax _____ Zhvilluesi _____
6	Drejtuesi teknik	Emër, mbiemër Rruga, numri shtëpisë, kodi postal, vendi	Telefon _____ Fax _____



	<p>Me anë të këtij dokumenti, vërtetoj si person përgjegjës për realizimin e projektit duke marrë përsipër detyrimet ligjore duke respektuar ligjet sipas nenit xxx për kohëzgjatjen dhe ekzekutimin e projektit të mësipërm. Unë jam i vetëdijshëm, se një devijim nga planet e ndërtimit të miratuara dhe nga kërkesat e ligjeve në fuqi për interesin publik mund të hapin procedura për kundërvajtje kundër meje.</p>	Drejtuasi teknik
--	---	------------------

VENDIM
Nr. 409, datë 13.5.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
 BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR
 PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR
 PAGESËN E SHPENZIMEVE
 ADMINISTRATIVE PËR ÇËSHTJEN E
 ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NR.
 ARB/14/26, “ALBANIABEG AMBIENT
 SHPK, M. ANGELO NOVELLI DHE
 COSTRUZIONI SRL KUNDËR
 REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) dollarë për të përballuar shpenzimet administrative për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/14/26, “Albaniabeg Ambient sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit (ICSID).

2. Fondi prej 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) dollarësh, i konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, t’i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës së buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 411, datë 13.5.2015

**PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET
 PËR DHËNIEN E PËRSËRITJEN E
 LICENCËS SË KONCESIONIT TË
 NAFTËSJELLËSVE PËR IMPORTIMIN,
 EKSPORTIMIN DHE TRANSPORTIMIN
 E NAFTËS BRUTO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 18, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Çdo person juridik, i krijuar sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe i organizuar në formën e shoqërisë aksionare mund të aplikojë për marrjen e një licence koncesioni të naftësjellësve, për kryerjen e veprimtarisë së transportimit, importimit dhe eksportimit të naftës bruto, në përputhje me rregullat që përcaktohen në këtë vendim, në bazë të parimeve të mosdiskriminimit, të trajtimit të barabartë dhe të transparencës.

2. Licenca e koncesionit të naftësjellësve, për kryerjen e veprimtarisë së transportimit, importimit dhe eksportimit të naftës bruto, merret nga personat juridikë të interesuar, pas pajisjes së tyre me miratimin paraprak, sikurse parashikohet në kreun II, dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi.



II. KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME MIRATIM PARAPRAK

1. Personat juridikë që kërkojnë të pajisen me licencë koncesioni të naftës-jellësve, për kryerjen e veprimtarisë së transportimit, importimit dhe eksportimit të naftës bruto, përpara fillimit të ndërtimit dhe vënies në funksionim të naftës-jellësve paraqesin, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, kërkesën për t'u pajisur me një miratim paraprak, me qëllim vazhdimin e procedurës, të shoqëruar me këto dokumente:

1.1 Ekstraktin e regjistrimit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku vërtetohet se personi juridik është i organizuar në formën e shoqërisë aksionare, ka të përcaktuar në objektin e veprimtarisë së tij transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto dhe se statusi i tij është aktiv.

1.2. Një përmbledhje me treguesit kryesorë teknikë, teknologjikë dhe financiarë të projektit të propozuar, për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës përkatëse për transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto, ose për lidhjen e sistemit shqiptar të naftës-jellësve me sistemet fqinje, të depozitave nëntokësore të naftës bruto, të linjave direkte si dhe të instalimeve të tjera, në funksion të këtyre objekteve, përfshirë edhe projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit.

1.3 Studimin paraprak të fizibilitetit për veprimtarinë që do të realizojë personi juridik.

1.4 Deklaratën mjedisore, në përfundim të procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, lëshuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, ose vendimin, në përfundim të procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi.

1.5 Genplanin e vendit ku parashikohet të ndërtohet naftës-jellësi dhe paraqitjen e dokumentacionit përkatës, që provon marrëdhënien e aplikuesit me truallin ku parashikon të ndërtojë naftës-jellësin (certifikatë pronësie, kontratë blerjeje ose kontratë qiraje etj, për një periudhë jo më të vogël se vlefshmëria e licencës së koncesionit për naftës-jellës), si më poshtë:

i) kur infrastruktura përkatëse e sistemeve të naftës-jellësit do të ndërtohet në territore në brendësi të vendit (tokë dhe det), nevojiten

skemë-ideja dhe genplani i sipërfaqes ku parashikohet të ndërtohet objekti;

ii) kur infrastruktura përkatëse e sistemeve të naftës-jellësit është pjesë e tubacioneve që kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë (në më shumë se dy vende në tokë dhe det), nevojiten skemë-ideja dhe genplani i sipërfaqes ku parashikohet të ndërtohet objekti, të shoqëruara me një skemë tërësore të të gjithë shtrirjes së objektit në vendet e tjera të rajonit, së bashku me përditësimet paraprake teknike dhe administrative, sipas situatës në terren, për territorin shqiptar. Pjesë e dokumentacionit është edhe praktika procedurale që disponon subjekti për marrëveshjen ose miratimin, në parim, të projektit, me vendet e tjera, në territoret e të cilave parashikohet të kalojnë tubacionet dhe infrastruktura përkatëse për transmetimin dhe shpërndarjen e naftës bruto, ose për lidhjen e sistemit shqiptar të naftës-jellësve me ato fqinje, si dhe linjat direkte.

1.6 Oponencën paraprake, nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në rastet e ndërtimeve që prekin parqet arkeologjike, qytetet-muze, zonat-muze, qendrat historike, zonat arkeologjike dhe ansamblet-muze, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

1.7 Dokumentacionin që vërteton përvojën e subjektit, të shoqërive të kontrolluara prej tij ose të kontraktorit të tij, në fushën e ndërtimit ose të përdorimit të infrastrukturës përkatëse në sistemet e naftës-jellësve. Nëse subjekti kërkues synon të përdorë, në operimet e tij të përditshme, një shoqëri menaxhimi, ai duhet të njoftojë për këtë ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dhe të garantojë performancën e kësaj shoqërie.

1.8 Dokumentin që vërteton se përdorimi i tokës ku do të ndërtohet naftës-jellësi është parashikuar për ndërtimin e objekteve të kësaj natyre, në një nga instrumentet e planifikimit të territorit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

1.9 Bilancin e tri viteve të fundit të veprimtarisë, të certifikuar nga organet tatimore, ose, kur shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, atë për periudhën e ekzistencës së shoqërisë.



1.10 Dokumente në formën e një letre interesi, marrëveshjeje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër që vërteton mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase a të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera), të nevojshme për ndërtimin e plotë të naftësijellës.

1.11 Deklarimin për vlerën e bonusit të nënshkrimit të licencës që ofron personi juridik në rastin e pajisjes me licencë koncesioni për naftësijellës. Vlera e bonusit të ofruar, në çdo rast, nuk duhet të jetë më pak se 1 000 000 (një milion) lekë. Në këtë rast, deklarimi duhet të shoqërohet me një garanci financiare bankare për vlerën e plotë të bonusit, në bazë të së cilës garantohet pagesa e këtij bonusi menjëherë me nënshkrimin e licencës së koncesionit të naftësijellës.

1.12 Vlerën e bonusit vjetor të trajnimit që ofron personi juridik në rastin e pajisjes me licencë koncesioni për naftësijellës.

1.13 Dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, lidhur me aktivitetin e shoqërisë, lëshuar nga organi kompetent.

1.14 Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria.

1.15 Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale kombëtare dhe vendore, lëshuar nga administrata tatimore, dhe dokumentin që vërteton se subjekti aplikues nuk ka detyrime doganore dhe të akcizës, lëshuar nga administrata doganore.

1.16 Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore.

1.17 Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesave të energjisë elektrike për çdo ambient ku shoqëria aplikuese ushtron aktivitetin.

Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Për dokumentet e përkthyer në gjuhën shqipe vërtetimi i nënshkrimit të përkthyesit bëhet nga noteri.

2. Për vlerësimin e kërkesave dhe dokumentacionit shoqërues, të paraqitura nga personat juridikë, për t'u pajisur me miratimin paraprak, për vazhdimin e procedurës për pajisjen

me licencë koncesioni për naftësijellës, pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet krijohet një komision i përhershëm vlerësimi.

2.1. Komisioni i vlerësimit ka në përbërje të tij përfaqësues nga:

- ministria përgjegjëse për hidrokarburet, 3 (tre) anëtarë;
- ministria përgjegjëse për zhvillimin urban, 1 (një) anëtar;
- ministria përgjegjëse për ekonominë, 1 (një) anëtar;
- ministria përgjegjëse për mjedisin, 1 (një) anëtar;
- ministria përgjegjëse për çështjet vendore, 1 (një) anëtar.

Ngritja e komisionit të vlerësimit të kërkesave dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

2.2. Komisioni i vlerësimit të kërkesave vlerëson kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga personi juridik, sipas përcaktimit të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi.

Në rast se për të njëjtën sipërfaqe toke ka më shumë se një person juridik që plotëson kushtet për dhënie e miratimit paraprak për vazhdim procedure, për pajisjen me licencë koncesioni të naftësijellësve, komisioni merr në konsideratë, si kriter për përzgjedhje, projektin teknologjik që do të aplikohet për ndërtimin e naftësijellësit dhe vlerën e bonuseve që ofron secili person juridik, në dispozicion të buxhetit të shtetit. Në këtë rast, në bazë të kriterëve të projektit teknologjik dhe vlerës së bonuseve të ofruara, komisioni i vlerësimit shqyrton të gjitha aplikimet dhe i propozon ministrit përgjegjës për hidrokarburet dhënie e miratimit paraprak për aplikuesin që propozon zgjidhjen më të mirë.

3. Komisioni i vlerësimit të kërkesave mbledhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesës, bën verifikimin e dokumentacionit përkatës të aplikimit dhe vepron, si më poshtë vijon:

a) Kur, pas verifikimit, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga personi juridik është i rregullt, komisioni pranon kërkesën dhe, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e mbledhjes, i paraqet ministrit përgjegjës për hidrokarburet propozimin për miratimin paraprak, për vazhdim të mëtejshëm të procedurës, deri në marrjen e licencës së koncesionit për ndërtimin e naftësijellësve;

b) Kur, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e kryera në institucionet e tjera dhe/ose në terren, rezulton se nuk plotësohen kushtet e



kërkuara, komisioni harton një raport dhe njofton subjektin aplikues për dokumentacionin që mungon dhe të drejtën e tij për të plotësuar dokumentacionin e kushtet përkatëse, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, nga data e dërgimit fillestar të njoftimit.

Subjekti aplikues ka të drejtë të riparaqesë aplikimin, me dokumentacionin e plotësuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit. Komisioni mbledhet dhe merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nga dita e depozitimit të dokumentacionit të plotësuar, ose brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nga dita e përfundimit të afatit të depozitimit, nëse subjekti aplikues nuk ka bërë plotësimin e dokumentacionit.

c) Kur, pas verifikimit përfundimtar, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1, të kreut II, të këtij vendimi, komisioni refuzon kërkesën dhe, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e mbledhjes, i kthen personit juridik dokumentacionin përkatës ku argumentohet vendimi i marrë. Personi juridik ka të drejtën e riaplikimit, pas plotësimit e saktësimit të dokumentacionit.

ç) Kur personi juridik nuk është dakord me vendimin e komisionit, ai ka të drejtën e ankimit brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit, pranë ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

4. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet, në procesin e vlerësimit të një kërkesë, mund të kërkojë ekspertizë dhe konsulencë nga ekspertë/institucione vendase ose të huaja dhe kostoja e këtij shërbimi mbulohet nga subjekti aplikues.

5. Vendimi i komisionit të vlerësimit, për miratim paraprak të kërkesës, duhet të përmbajë:

a) emrin dhe NIPT-in e personit juridik, që paraqet kërkesën;

b) të drejtën për përgatitjen e dokumentacionit të plotë në zonën përkatëse, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe këtij vendimi, për marrjen e licencës së koncesionit për naftësjellësit;

c) afatin kohor të vlefshmërisë së miratimit për vazhdim procedure, brenda të cilit duhet të përfundojë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e licencës së koncesionit për ndërtimin e naftësjellësve, deri në paraqitjen e tij në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet për

procedim të mëtejshëm. Në çdo rast, ky afat nuk mund të jetë më shumë se dy vjet.

III. PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME LICENCË KONCESIONI TË NAFTË-SJELLËSVE

1. Personi juridik, i pajisur me miratimin paraprak për vazhdim procedure, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, dokumentacionin për marrjen e licencës së koncesionit të naftësjellësve. Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

1.1 Ekstraktin e regjistrit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, të personit juridik, ku vërtetohet se subjekti ka të përcaktuar në objektin e veprimtarisë transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto dhe se statusi i tij është aktiv;

1.2 Lejen e mjedisit të tipit A apo B, të lëshuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi;

1.3 Lejen e zhvillimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

1.4 Skemën kryesore me treguesit teknikë dhe ekonomikë të projektit, të hartuar nga ekspertë të fushës, të licencuar, vendas apo të huaj, si dhe planbизнесin e përgatitur nga subjekti. Skema kryesore me treguesit teknikë duhet të jetë e miratuar nga inspektorati shtetëror përgjegjës;

1.5 Skemën tërësore të naftësjellësit, për të gjithë shtrirjen e tij, përfshirë edhe rastin kur ai kalon në vendet e tjera të rajonit, ku parashikohet të ndërtohet objekti. Në këtë rast, subjekti duhet të depozitojë edhe dokumentacionin ligjor dhe teknik që vërteton marrëveshjen paraprake ose përfundimtare me autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera, për ndërtimin e naftësjellësit, përfshirë edhe linjat direkte;

1.6 Studimin e fizibilitetit, për veprimtarinë që do të realizojë personi juridik;

1.7 Kontratën e punësimit të drejtuesit teknik që do të ndjekë realizimin e projektit të naftësjellësit dhe vënien në përdorim të tij;

1.8 Genplanin e vendit ku parashikohet të ndërtohet naftësjellësi si dhe dokumentacionin përkatës që provon marrëdhënien e aplikuesit me truallin ku parashikon të ndërtojë naftësjellësin (certifikatë pronësie, kontratë blerjeje, kontratë qiraje etj, për një periudhë jo më të vogël se



vlefshmëria e licencës së koncesionit për naftësjellës);

1.9 Dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, lidhur me aktivitetin profesional, lëshuar nga organi kompetent;

1.10 Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria;

1.11 Dokumentacion në formën e një letre interesi, marrëveshjeje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase a të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera) për të përbulluar ndërtimin e naftësjellësit.

1.12 Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale, të lëshuar nga administrata tatimore dhe dokumentin që vërteton se personi juridik nuk ka detyrime doganore dhe të akcizës, lëshuar nga administrata doganore.

2. Licenca e koncesionit të naftësjellësve përgatitet nga struktura përgjegjëse për hidrokarburet, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, në bashkëpunim me personin juridik kërkues ose përfaqësuesin ligjor të tij.

3. Licenca e koncesionit të naftësjellësve, së bashku me të gjitha dokumentet e përgatitura sipas këtij vendimi, përfshirë kopje të miratimit paraprak për vazhdim procedure, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

4. Licenca e koncesionit të naftësjellësve duhet të përmbajë, të paktën, këto të dhëna:

a) emrin dhe selinë e personit juridik;

b) vendndodhjen ose zonën e shtrirjes së objektit të infrastrukturës së sistemeve të naftësjellësve, përfshirë edhe përcaktimin e kufijve e të sektorëve të veçantë të tij;

c) numrin dhe datën e vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së zhvillimit;

ç) afatin e vlefshmërisë së licencës së koncesionit si dhe të drejtën për përsëritjen e kësaj licence, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës nga personi juridik, sipas procedurave të përcaktuara në kreun IV, të këtij vendimi;

d) afatin e përfundimit të ndërtimit të naftësjellësit, afatin e vënies në përdorim si dhe

rastet kur do të lejohet shtyrja e afatit të ndërtimit apo vënies në përdorim;

dh) të drejtën e organeve dhe institucioneve shtetërore, të ngarkuara me ligj, për kontrollin e zbatimit të projektit, sipas kushteve dhe afatit të përcaktuar në projekt;

e) të drejtën e Këshillit të Ministrave për shfuqizimin e kësaj licence kur, nga kontrollet e ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, konstatohet dështimi i përmbushjes së kërkesave të licencës së koncesionit të naftësjellësve në zbatimin e parametrave teknike, në afatin e realizimit të projektit dhe në normat mjedisore;

ë) kapacitetin për produktet që do të transportojë dhe detyrimi për hartimin e një plani të detajuar, çdo 5 (pesë) vjet, për mirëmbajtjen e kapaciteteve ekzistuese;

f) detyrimet financiare që personi juridik ka ndaj shtetit, në lidhje me licencën e koncesionit;

g) të dhënat që duhet të paraqesë personi juridik në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, brenda afateve të përcaktuara me urdhër të ministrit;

gj) detyrimin për depozitim të kontratave të lidhura me palët e interesuara, për realizimin e importit apo eksportit, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e lidhjes së tyre;

h) kalimin e të drejtave dhe/ose detyrimeve të kontratës dhe ndryshimin e aksionarëve të shoqërisë;

i) detyrimin e subjektit për respektimin e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe të marrëveshjeve, të konventave apo të traktateve ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë;

Në licencën e koncesionit për naftësjellës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, mund të përfshihen edhe përcaktime të tjera ose detyrime të ndërsjella.

5. Licenca e koncesionit për naftësjellës hartohet në tri kopje, nga të cilat një kopje mbahet në Këshillin e Ministrave, një në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dhe një për subjektin përkatës.

6. Dhënia e licencës së koncesionit për naftësjellës, për ndërtimin e naftësjellësit, për transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto, bëhet kundrejt pagesës së tarifës prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh nga personi juridik,



shumë e cila derdhet, tërësisht, në buxhetin e shtetit.

7. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të shfuqizojë licencën e koncesionit me propozimin e ministrit përgjegjës për hidrokarburet, kur, gjatë kontrolleve të ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, konstaton shkelje ose mosrespektim të kërkesave të licencës së koncesionit të naftësjesve, moszbatim të parametrave teknike të projektit, mosrespektim të afatit të realizimit të tij, të normave mjedisore dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në licencë, që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

8. Personi juridik, i pajisur me licencë koncesioni, në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për marrjen e lejes së ndërtimit të objektit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Në përfundim të ndërtimit të naftësjesit, personi juridik paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për marrjen e certifikatës së përdorimit të objektit, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

IV. PROCEDURAT PËR PËRSËRITJEN E LICENCËS SË KONCESIONIT PËR NAFTËSJELLËS

1. Personi juridik, i pajisur me licencën e koncesionit të naftësjesve, ka të drejtë për përsëritjen e saj, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës nga ana e tij, jo më vonë se 1 vit para përfundimit të afatit të licencës.

2. Mbajtësi i licencës së koncesionit të naftësjesve paraqet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet kërkesën për përsëritje të licencës, të shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikat 1.1, 1.2, 1.4, 1.7, 1.9 e 1.10, të pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi.

Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Për dokumentet e përkthyer në gjuhën shqipe vërtetimi i nënshkrimit të përkthyesit bëhet nga noteri.

3. Kërkesa për përsëritjen e licencës së koncesionit të naftësjesve, së bashku me të gjitha dokumentet, shqyrtohet nga struktura përgjegjëse për hidrokarburet, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Përsëritja e licencës së koncesionit për naftësjesve bëhet kundrejt pagesës prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, nga personi juridik, shumë e cila derdhet, tërësisht, në buxhetin e shtetit.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Dispozitat e vendimit nr. 553, datë 12.8.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve të koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftësjesve e gazsjellsve”, të ndryshuar, zbatohen për procedurat e dhënies së licencës së koncesionit të naftësjesve, aplikimet e të cilave janë depozituar në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 412, datë 13.5.2015

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 775, DATË 14.11.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SKAVICË”, NË LUMIN DRINI I ZI, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 775, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Skavicë”, në lumin Drini i Zi, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, të ndryshuar.



2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 413, datë 13.5.2015

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIM, PËR PARCELAT QË DO TË NDIKOHEN NGA NDËRTIMI, PREJ SHOQËRISË TAP AG, I RRUGËS SË KALIMIT (NDIHMËSE), “PRONOVIK-ZGËRBONJË-ANTENA”, QARKU BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, të nenit 59, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe të neneve 16 e 28, pika 28.6, të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin për ndryshimin e statusit të tokës bujqësore dhe kalimin në tokë truall, për parcelat, me sipërfaqe të përgjithshme 19 813 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e trembëdhjetë) m², që do të ndikohen nga ndërtimi, prej shoqërisë TAP AG, i rrugës së kalimit (ndihmëse) “Pronovik-Zgërbonjë-Antena”, Qarku Berat, në funksion të ndërtimit të Gazsjellësit TAP. Parcelat që ndryshojnë statusin nga tokë bujqësore në tokë truall jepen në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse

e tij.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Qarku Berat, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimin e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore në tokë urbane (truall), për sipërfaqen prej 19 813 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e trembëdhjetë) m², sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të pronësisë, ndërmjet shoqërisë TAP AG dhe pronarëve aktualë të këtyre parcelave, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme për të ndërtuar dhe operuar rrugën e kalimit (ndihmëse) “Pronovik-Zgërbonjë-Antena”, për projektin e Gazsjellësit TAP, sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të bëhen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, si dhe gjithë legjislacionit tjetër në fuqi.

4. Shoqëria TAP AG dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të vendimit nr. 245, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimin e të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të bëjnë ndryshimet në regjistrat dhe kartelat e pasurisë/pasurive përkatëse, për sa u përket marrëdhënieve të pronësisë, për parcelat që do të ndikohen nga ndërtimi i rrugës së kalimit (ndihmëse) “Pronovik-Zgërbonjë-Antena”, të cilave do t’u ndryshohet statusi nga tokë bujqësore në tokë truall.

5. Shoqëria TAP AG, pas përfundimit të punimeve për ndërtimin e rrugës së kalimit (ndihmëse) “Pronovik-Zgërbonjë-Antena”, është e detyruar të realizojë rehabilitimin mjedisor të territorit, në ato pjesë të parcelave që janë



ndikuar nga ndërtimi i kësaj rruge të kalimit (ndihmëse) për projektin TAP, por që nuk do të përfshihen si pjesë e këtij rrjeti rrugor.

6. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zyra e Regjistrimit

të Pasurive të Paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, nga kalon rrjeti i rrugëve të kalimit (ndihmëse) për ndërtimin e Gazsjellësit TAP, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E TOKAVE BUJQËSORE TË NDIKUARA NGA RRUGA E KALIMIT 454

Qarku	ZK	ID1	ID2	Nr. RRUGES	RRETHI	ZONA KADASTRALE (ZK)	SIPERFAQJE E PARCELES (ha)	SIP. E PREKUR (ha)	PERDORIMI
Berat	3909	688	20000BR00003909006880000000	454	Berat	3909	1.3516	0.0280	TOKE BUJQESORE
	3909	683	20000BR00003909006830000000	454	Berat	3909	0.1836	0.0408	TOKE BUJQESORE
	3909	798	20000BR00003909007980000000	454	Berat	3909	0.1178	0.0232	TOKE BUJQESORE
	3909	689	20000BR00003909006890000000	454	Berat	3909	1.2632	0.0267	TOKE BUJQESORE
	3909	690	20000BR00003909006900000000	454	Berat	3909	0.0479	0.0288	TOKE BUJQESORE
	3909	694	20000BR00003909006940000000	454	Berat	3909	0.1328	0.0148	TOKE BUJQESORE
	3909	595	20000BR00003909005950000000	454	Berat	3909	0.0917	0.0577	TOKE BUJQESORE
	3909	682	20000BR00003909006820000000	454	Berat	3909	0.6165	0.1430	TOKE BUJQESORE
	3909	593	20000BR00003909005930000000	454	Berat	3909	0.0754	0.0158	TOKE BUJQESORE
	3909	672	20000BR00003909006720000000	454	Berat	3909	0.0162	0.0071	TOKE BUJQESORE
	3909	693	20000BR00003909006930000000	454	Berat	3909	0.4370	0.0014	TOKE BUJQESORE
	3909	594	20000BR00003909005940000000	454	Berat	3909	0.0649	0.0011	TOKE BUJQESORE
	3909	680	20000BR00003909006800000000	454	Berat	3909	0.2230	0.0062	TOKE BUJQESORE
	3909	592	20000BR00003909005920000000	454	Berat	3909	0.0343	0.0065	TOKE BUJQESORE
	3909	586	20000BR00003909005860000000	454	Berat	3909	0.1842	0.0125	TOKE BUJQESORE
	3909	684	20000BR00003909006840000000	454	Berat	3909	0.0735	0.0134	TOKE BUJQESORE
	3909	695	20000BR00003909006950000000	454	Berat	3909	0.3150	0.0665	TOKE BUJQESORE
	3909	701	20000BR00003909007010000000	454	Berat	3909	0.0160	0.0086	TOKE BUJQESORE
	3909	585	20000BR00003909005850000000	454	Berat	3909	0.1294	0.0002	TOKE BUJQESORE
	3909	700	20000BR00003909007000000000	454	Berat	3909	0.0266	0.0097	TOKE BUJQESORE
	3909	662	20000BR00003909006620000000	454	Berat	3909	0.5016	0.0285	TOKE BUJQESORE
	3909	685	20000BR00003909006850000000	454	Berat	3909	0.4617	0.0530	TOKE BUJQESORE
	3909	686	20000BR00003909006860000000	454	Berat	3909	0.0781	0.0023	TOKE BUJQESORE
	3909	670	20000BR00003909006700000000	454	Berat	3909	0.4348	0.0024	TOKE BUJQESORE
	3909	575	20000BR00003909005750000000	454	Berat	3909	0.1042	0.0007	TOKE BUJQESORE
	3909	538/1	20000BR00003909005380001000	454	Berat	3909	0.1802	0.0083	TOKE BUJQESORE
	3909	1196	20000BR00003909011960000000	454	Berat	3909	0.6760	0.0475	TOKE BUJQESORE
	3909	1012	20000BR00003909010120000000	454	Berat	3909	0.7421	0.0400	TOKE BUJQESORE
	3909	1002	20000BR00003909010020000000	454	Berat	3909	0.6446	0.0051	TOKE BUJQESORE
	3909	260	20000BR00003909002600000000	454	Berat	3909	0.2558	0.0130	TOKE BUJQESORE
	3909	294	20000BR00003909002940000000	454	Berat	3909	0.3307	0.0608	TOKE BUJQESORE
	3909	282	20000BR00003909002820000000	454	Berat	3909	1.4568	0.0620	TOKE BUJQESORE
	3909	285	20000BR00003909002850000000	454	Berat	3909	0.9293	0.1982	TOKE BUJQESORE
	3909	258	20000BR00003909002580000000	454	Berat	3909	0.9395	0.0521	TOKE BUJQESORE
	3909	292	20000BR00003909002920000000	454	Berat	3909	1.4921	0.0005	TOKE BUJQESORE
	3909	297	20000BR00003909002970000000	454	Berat	3909	2.8955	0.1335	TOKE BUJQESORE
	3909	279/1	20000BR00003909002790001000	454	Berat	3909	0.6732	0.0007	TOKE BUJQESORE
	3909	255	20000BR00003909002550000000	454	Berat	3909	0.9421	0.0219	TOKE BUJQESORE
	3909	274	20000BR00003909002740000000	454	Berat	3909	0.4309	0.1116	TOKE BUJQESORE
	3909	276	20000BR00003909002760000000	454	Berat	3909	0.5779	0.2479	TOKE BUJQESORE
	3909	253/1	20000BR00003909002530001000	454	Berat	3909	0.8054	0.0001	TOKE BUJQESORE
	3909	275	20000BR00003909002750000000	454	Berat	3909	1.4903	0.1128	TOKE BUJQESORE
	3909	254	20000BR00003909002540000000	454	Berat	3909	0.3717	0.1208	TOKE BUJQESORE
	3909	238	20000BR00003909002380000000	454	Berat	3909	0.1799	0.0212	TOKE BUJQESORE
	3909	288	20000BR00003909002880000000	454	Berat	3909	2.5541	0.0578	TOKE BUJQESORE
3909	246	20000BR00003909002460000000	454	Berat	3909	0.6500	0.0664	TOKE BUJQESORE	
						Total Rruga e kalimit 454	26.1990	1.9813	

VENDIM

Nr. 414, datë 13.5.2015

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSINË E SAJ TË NDJEKJES DHE ZBATIMIT TË PROJEKTIDEVE TË KONKURSIT “ËNDRRA IME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit

nr.160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i kalon përgjegjësia për ndjekjen e zbatimit të projektideve fituese në kuadër të konkursit “Ëndrra ime”, sipas listës së dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të realizojë ndjekjen e projektideve fituese nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Rinisë.

3. Rregullat e veçanta për mënyrën e



monitorimit, raportimit dhe disbursimit të fondit përkatës nga Shërbimi Kombëtar i Rinisë për zbatimin e projektideve fituese do të përcaktohen me udhëzim të posaçëm të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Për financimin e projektideve fituese, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh.

5. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimi Kombëtar i Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS 1 LISTA ME FITUESIT

1. “Trajnimi i të verbërve përmes një programi kompjuterik për nevojat e tyre”, me fitues Gjergj Gjergji Ndoci.

2. “Pastrimi i liqenit të Tiranës nga mbetjet biologjike dhe mbeturinat e hedhura në një thellësi deri 1.8”, me fitues Shkëlzen Muhamet Dunisha.

3. Krijimi i “DoctorScore”, një aplikacion që do të realizojë vlerësimin e shërbimit të mjekut nga pacientët, si dhe mundësinë e të sëmurve për t’u konsultuar përmes tij mbi cilësinë e shërbimit që ofron mjeku”, me fitues Migel Agim Parllaku.

4. “Ngritja e bibliotekës në shkollën “Sadi Nuri” të Ndroqit, përmes organizimit vullnetar”, me fitues Patricia Nadir Pollozi.

5. “Krijimi i një portali që do të katalogojë, do të promovojë dhe do të shesë punime artizanale të grave të veriut”, me fitues Admir Ibrahim Daka.

6. “Festivali i Luleve, ku do të ekspozohen dhe do të promovohen produktet bimore, kopshtaria, artet si edhe politikat komunitare mbi mjedisin në qytetin e Përmetit”, me fitues Joreld Kristul Dhamo.

7. “Krijimi një aplikacioni që u vjen në ndihmë me informacion në kohë reale udhëtarëve të transportit publik urban”, me fitues Elsin Avdi Berberi.

8. “Ngritja e bibliotekës në shkollën e mesme të bashkuar të Ballagatit”, me fitues Alesia Azbi

Markaj.

9. “Menaxhimi elektronik në sektorin e bujqësisë, përmes një aplikacioni që integron të gjithë sferën e prodhimit bujqësor”, me fitues Hristofor Ahile Miho.

10. “Ndërtimi i një stacioni biçikletash me qira në qytetin e Korçës ku biçikletat do të jepen në këmbim të një libri dhe me librat e mbledhur do të çelet një bibliotekë publike”, me fitues Megi Edmond Hasani.

11. “Përfaqësimi i Shqipërisë në një Maratonë Ndërkombëtare”, me fitues Rej Edmond Bedini.

12. “Vendosja e një teme për çdonjërin nga 35 javët e vitit shkollor”, me fitues Alba Arben Verushi.

13. “Shërbimi përmes një numri jeshil për punësimin e të rinjve në bashkëpunim me pushtetin vendor, sipërmarrjen dhe shkollat profesionale”, me fitues Ardit Sadri Mekshiqi.

14. “Trainimi për gjuhën e shenjave dhe rritjen e ndjeshmërisë sociale ndaj personave me probleme në të folur e në dëgjim”, me fitues Desli Mihal Shahini.

15. “E-Book shëndetësor, një manual elektronik me informacion për sëmundjet më të njohura në funksion të edukimit shëndetësor të qytetarëve”, me fitues Aurel Hajdar Celami.

16. “Rehabilitimi vullnetar i një parku në qytetin e Vlorës”, me fitues Realdo Vullnet Silaj.

17. “Krijimi i një Programi Kombëtar Praktike (Internship) për nxënës e studentë që duan të praktikojnë dijet e tyre dhe të mësojnë përmes praktikës pranë institucioneve shtetërore”, me fitues Klerentina Niko Hoxha.

18. “Vënia në skenë në Amfiteatrin e Durrësit të veprave me famë botërore”, me fitues Uni Rinor (Durrës), Josiba Fatmir Osmani.

19. “Projekti për edukimin joformal të të rinjve përmes artit pamor”, me fitues Klea Gentian Vyshka dhe Marinela Besim Rukia.

20. “Projekti për ngritjen e Akademisë Sociale të Futbollit, duke nisur nga ndërtimi i një fushe të parë futbollit që do të përdoret për adoleshentë në kushte të vështira sociale”, me fitues Gjergj Ndoc Ndoci.

21. “Trajnim grash e vajzash se si mund të përfitojnë nga teknologjia dixhitale për të ngushtuar hendekun e pabarazisë gjinore”, me fitues Klea Vasil Mertenika.



22. “Eksozitë me arkivin fotografik familjar të viteve 1915 – 1962 në një shtëpi “Monument culture” në qytetin e Pogradecit”, me fitues Amanda Ilija Cici.

23. “Krijimi i një mjedisi riciklimi të shisheve plastike që transformohen në material për dekor artistik në shkollë”, me fitues Aleksanër Fran Prendi.

24. “Ngritja e një biznesi familjar për rritjen e bletëve dhe shitjen e mjaltit”, me fitues Mariglen Kamber Balliu.

25. “Rindërtimi i mullirit të fshatit për t’i shërbyer komunitetit duke shkurtuar rrugën dhe kohën e bashkëfshatarëve për bluarjen e prodhimeve të tyre”, me fitues Andi Xhevair Kukli.

26. “Mbështetje të biznesit familjar të një emigranti pas kthimit nga emigracioni dhe vetëpunësimit të katër personave”, me fitues Fatjon Ismajl Selimaj.

27. “Hapja e një pasticerie nga një e re me 3 fëmijë dhe ndihmë sociale”, me fitues Rudina Skënder Qoska.

28. “Promovimi i qendrës komunitare të ngritur nga të rinjtë e fshatit Marqinet që synon tanimë shtrirjen përtej fshatit”, me fitues Gentjan Hamid Hajdari.

29. “Promovimi i kulturës, traditave dhe produkteve të Alpeve Shqiptare duke synuar t’i shërbejë nxitjes së turizmit në këtë zonë të vendit”, me fitues Mirsad Fatmir Bashi.

VENDIM

Nr. 415, datë 13.5.2015

PËR PËRDORIMIN E BARNAVE PËR KONSUM MINIMAL NGA UDHËTARËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ë”, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 105, datë 31.7.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Barnat për konsum minimal nga udhëtarët nuk pajisen me autorizim tregtimi nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2. Lejohet hyrja, në territorin e Republikës së Shqipërisë, e udhëtarëve me sasi barnash për përdorim personal, në rastet kur:

a) këto barna nuk do të përdoren për qëllim promovimi dhe/ose tregtimi;

b) individi, i cili mban barin, plotëson deklaratë me shkrim ku përcakton se bari është për përdorimin e tij personal dhe jep informacion për kontaktet e mjekut që i ka përshkruar trajtimin e barit, në Republikën e Shqipërisë, ose vërteton që ky trajtim ka nisur në një shtet të huaj. Kjo deklaratë depozitohet pranë autoriteteve doganore të pikës hyrëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) sasia e barit të sjellë për trajtimin e individit është e tillë që përfshin trajtimin e pacientit për një periudhë jo më shumë se 2 muaj, e justifikuar me recetën shoqëruese të mjekut, ku përcaktohet doza ditore e barit për trajtim. Për shtetasit me qëndrim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sasia e barit që duhet të mbajë një person me vete duhet të jetë në përputhje me kohën e qëndrimit të tij në Shqipëri;

Barnat me kushte specifike transporti, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që trajtojnë transportin e barnave, nuk lejohen të sillen nga individë.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 417, datë 13.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 52, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2015”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Pika 6, e vendimit nr. 52, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Financimi i masës mbështetëse për prodhimin në serra me ngrohje qendrore, skemë e vitit 2014, të bëhet deri më 30 qershor të vitit 2015, me fondet e caktuara për vitin përkatës buxhetor, por sipas masës dhe kushteve të përfitimit, të përcaktuar për vitin 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 418, datë 13.5.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 302, DATË 8.4.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “PLEPA-
KAVAJË-RRGOZHINË, LOTET 6-11
(OBJEKTE DHE TOKA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

Objektet që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të aksit “Plepa-Kavajë-Rrogozhinë ” Loti 6-11 (lista me ndryshimet përkatëse)

Nr	Pronari			Z.K.	Nr. Pas.	EMËRTIMI I OBJEKTEVE	OBJEKTE (M ²)	TRUALL			Shënime	
	Emri	Atësia	Mbiemri					SIP. (M ²)	ÇMIMI (LEK/M ²)	VLERA		VLERA TOTALE (LEKE)
19	Zyber	Daut	Cullhaj	8552	1/153	Banesë 2kt Loti 7	434.0				11,442,645	Certifikatë pronësie
67	Xhevat	Tahir	Hoxha	8552	18/448	shesh, investim Loti 7					410,550	leje ndërtimi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 302, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 134 795 890 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “truall”, me sipërfaqe 1 161 (një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) m², me vlerë 2 594 752 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë;

b) objekte, me vlerë 132 201 138 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e dyqind e një mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.”.

2. Në pikën 4 dhe në tabelën bashkëlidhur vendimit, shifra “...126 660 438 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e tetë)...” zëvendësohet me “...134 795 890 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë)...”.

3. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, të dhënat në nënndarjen nr. 19 ndryshohen dhe shtohet nënndarja nr. 67, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 420, datë 20.5.2015**

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRIT, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me

ligj”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 6 shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“Paga për pozicionin kryendihmës në kabinetin e Kryeministrit është 139 000 (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë) lekë.

Të drejtën për të pasur ndihmës të jashtëm e ka vetëm Kryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës së kategorisë I-b. Masa e pagesës përcaktohet nga Kryeministri.”.

b) Në lidhjen 3/1, “Kategorizimi i pozicioneve të veçanta të punës për funksionet e veçanta në Kryeministri”, shtohet emërtesa “Kordinator – III-a”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2015, të përballohen nga fondet e miratuara për Kryeministrinë për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRIT
Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë